

**KOMBET
E BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale
të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda
të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të
Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej
vitit 1991

Data: Shtator 2009

Original: anglisht & frëngjisht

**STATUTI I AKTUALIZUAR
I TRIBUNALIT PENAL
NDËRKOMBËTAR
PËR
ISH-JUGOSLLAVINË**

(MIRATUAR MË 25 MAJ 1993 ME REZOLUTËN 827)
(NDRYSHUAR MË 13 MAJ 1998 ME REZOLUTËN 1166)
(NDRYSHUAR MË 30 NËNTOR 2000 ME REZOLUTËN 1329)
(NDRYSHUAR MË 17 MAJ 2002 ME REZOLUTËN 1411)
(NDRYSHUAR MË 14 GUSHT 2002 ME REZOLUTËN 1431)
(NDRYSHUAR MË 19 MAY 2003 ME RESOLUTËN 1481)
(NDRYSHUAR MË 20 APRIL 2005 ME REZOLUTËN 1597)
(NDRYSHUAR MË 28 SHKURT 2006 ME REZOLUTËN 1660)
(NDRYSHUAR MË 29 SHTATOR 2008 ME REZOLUTËN 1837)
(NDRYSHUAR MË 7 KORRIK 2009 ME REZOLUTËN 1877)

REZOLUTAT NË LIDHJE ME TPNJ-në:

Rezoluta 1503 e 28 gushtit 2003
Rezoluta 1504 e 4 shtatorit 2003
Rezoluta 1534 e 26 marsit 2004
Rezoluta 1591 e 18 janarit 2005
Rezoluta 1613 e 26 korrikut 2005
Rezoluta 1629 e 30 shtatorit 2005
Rezoluta 1668 e 10 prillit 2006
Rezoluta 1775 e 14 shtatorit 2007
Rezoluta 1786 e 28 nëntorit 2007
Rezoluta 1800 e 20 shkurtit 2008

(Ky dokument nuk është zyrtar dhe është hartuar në bazë të rezolutave origjinale të Kombeve të Bashkuara.)

**STATUTI I AKTUALIZUAR
I TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË**

(MIRATUAR MË 25 MAJ 1993 ME REZOLUTËN 827)
(NDRYSHUAR MË 13 MAJ 1998 ME REZOLUTËN 1166)
(NDRYSHUAR MË 30 NËNTOR 2000 ME REZOLUTËN 1329)
(NDRYSHUAR MË 17 MAJ 2002 ME REZOLUTËN 1411)
(NDRYSHUAR MË 14 GUSHT 2002 ME REZOLUTËN 1431)
(NDRYSHUAR MË 19 MAY 2003 ME RESOLUTËN 1481)
(NDRYSHUAR MË 20 APRIL 2005 ME REZOLUTËN 1597)
(NDRYSHUAR MË 28 SHKURT 2006 ME REZOLUTËN 1660)
(NDRYSHUAR MË 29 SHTATOR 2008 ME REZOLUTËN 1837)
(NDRYSHUAR MË 7 KORRIK 2009 ME REZOLUTËN 1877)

STATUTI I AKTUALIZUAR I TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË.....	3
REZOLUTA 808 (1993).....	19
REZOLUTA 827 (1993).....	21
REZOLUTA 1166 (1998).....	23
Shtojcë	25
REZOLUTA 1329 (2000).....	26
Shtojca I.....	28
Shtojca II	31
REZOLUTA 1411 (2002).....	34
Shtojca I.....	35
Shtojca II	36
REZOLUTA 1431 (2002).....	38
Shtojca I.....	39
Shtojca II	42
REZOLUTA 1481 (2003).....	44
Shtojcë	45
REZOLUTA 1597 (2005).....	46
Shtojcë	47
REZOLUTA 1660 (2006).....	48
Shtojcë	49
REZOLUTA 1837 (2008).....	52
Shtojcë	54
REZOLUTA 1877 (2009).....	56
Shtojcë	59
REZOLUTA NË LIDHJE ME TPNJ-në.....	60
<i>Rezoluta që nuk përmbajnë ndryshime të Statutit, por që kanë lidhje me TPNJ-në.</i>	
REZOLUTA 1503 (2003)	62
Shtojca I.....	64
REZOLUTA 1504 (2003)	66
REZOLUTA 1534 (2004)	68
REZOLUTA 1581 (2005)	70
REZOLUTA 1613 (2005)	72

REZOLUTA 1629 (2005)	75
REZOLUTA 1668 (2006)	77
REZOLUTA 1775 (2007)	79
REZOLUTA 1786 (2007)	81
REZOLUTA 1800 (2008)	83

**STATUTI I AKTUALIZUAR I TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR
PËR ISH-JUGOSLLAVINË**

PASQYRA E LËNDËS

Neni 1	9
Kompetenca e Tribunalit Ndërkombëtar	
Neni 2	9
Shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949	
Neni 3	9
Shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës	
Neni 4	10
Gjenocid	
Neni 5	10
Krimet kundër njerëzimit	
Neni 6	10
Juridiksioni individual	
Neni 7	10
Përgjegjësia penale individuale	
Neni 8	11
Juridiksioni hapësinor dhe kohor	
Neni 9	11
Juridiksioni i njëkohshëm	
Neni 10	11
<i>Non-bis-in-idem</i>	
Neni 11	11
Organizimi i Tribunalit Ndërkombëtar	
Neni 12	12
Përbërja e Dhomave	
Neni 13	12
Kualifikimet e gjykatësve	
Neni 13 bis	12
Zgjedhja e gjykatësve të përhershëm	
Neni 13 ter.....	13
Zgjedhja dhe emërimi i gjykatësve <i>ad litem</i>	
Neni 13 quater	13
Statusi i gjykatësve <i>ad litem</i>	
Neni 14	14
Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave	

Neni 15	14
Rregullorja e Procedurës dhe Provave	
Neni 16	15
Prokurori	
Neni 17	15
Sekretaria	
Neni 18	15
Hetimi dhe përgatitja e aktakuzës	
Neni 19	15
Shqyrtimi i aktakuzës	
Neni 20	16
Fillimi dhe zhvillimi i procesit gjyqësor	
Neni 21	16
Të drejtat e të akuzuarve	
Neni 22	16
Mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve	
Neni 23	17
Aktgjykimi	
Neni 24	17
Ndëshkimet	
Neni 25	17
Procedura e Apelit	
Neni 26	17
Procedura e rishqyrtimit	
Neni 27	17
Zbatimi i dënimeve	
Neni 28	17
Falja ose ulja e dënimit	
Neni 29	18
Bashkëpunimi dhe ndihma juridike	
Neni 30	18
Statusi, privilegjet dhe imunitetet e Tribunalit Ndërkombëtar	
Neni 31	18
Selia e Tribunalit Ndërkombëtar	
Neni 32	18
Shpenzimet e Tribunalit Ndërkombëtar	
Neni 33	18
Gjuhët e punës	
Neni 34	18
Raporti vjetor	

STATUTI I AKTUALIZUAR I TRIBUNALIT PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË

(MIRATUAR MË 25 MAJ 1993 ME REZOLUTËN 827)
(NDRYSHUAR MË 13 MAJ 1998 ME REZOLUTËN 1166)
(NDRYSHUAR MË 30 NËNTOR 2000 ME REZOLUTËN 1329)
(NDRYSHUAR MË 17 MAJ 2002 ME REZOLUTËN 1411)
(NDRYSHUAR MË 14 GUSHT 2002 ME REZOLUTËN 1431)
(NDRYSHUAR MË 19 MAY 2003 ME RESOLUTËN 1481)
(NDRYSHUAR MË 20 APRIL 2005 ME REZOLUTËN 1597)
(NDRYSHUAR MË 28 SHKURT 2006 ME REZOLUTËN 1660)
(NDRYSHUAR MË 29 SHTATOR 2008 ME REZOLUTËN 1837)
(NDRYSHUAR MË 7 KORRIK 2009 ME REZOLUTËN 1877)

I themeluar nga Këshilli i Sigurimit bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991 (më tej: "Tribunali Ndërkombëtar") vepron në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 1

Kompetenca e Tribunalit Ndërkombëtar

Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 2

Shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949

Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë që të procedojë penalisht individë që kryejnë ose urdhërojnë kryerjen e shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës të datës 12 gusht 1949, gjegjësisht veprimet e mëposhtme kundër individëve ose pronës të mbrojtura prej dispozitave të Konventës përkatëse të Gjenevës:

- (a) vrasje e qëllimshme;
- (b) tortura ose trajtim çnjerëzor, duke përfshirë eksperimente biologjike;
- (c) shkatërim i qëllimshëm i vuajtjes së madhe ose i lëndimeve të rënda trupore ose shëndetësore;
- (d) shkatërrim i gjerë dhe përvetësim prone, i pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe i kryer në mënyrë të jashtëligjshme dhe pa arsye;
- (e) detyrim i një robi lufte ose civili që të shërbejë në forcat e një fuqie armike;
- (f) privim i qëllimshëm i robërve të luftë ose civilëve prej të drejtës së tyre për gjykim të drejtë dhe të rregullt;
- (g) dëbim ose transferim i paligjshëm, ose heqje e paligjshme e lirisë së një civili;
- (h) marrje peng e civilëve.

Neni 3

Shkeljet e ligjeve ose zakoneve të luftës

Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë që shkelin ligjet ose zakonet e luftës. Ndër shkelje të tilla përfshihen:

- (a) përdorim i armëve helmuese ose i armëve të tjera të paramenduara të shkaktojnë vuajtje të panevojshme;
- (b) shkatërrim pa shkak i qyteteve ose fshatrave, ose shkretime i pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake;
- (c) sulm ose bombardim me çfarëdo mjetesh i qyteteve, fshatrave, banesave ose ndërtesave të pambrojtura;

- (d) zaptim, shkatërrim, ose dëmtim i qëllimshëm i institucioneve fetare, bamirëse, arsimore, artistike dhe shkencore, i monumenteve historike dhe i veprave të artit dhe të shkencës;
- (e) plaçkitje e pronës publike ose private.

Neni 4 Gjenocid

1. Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë që kryejnë gjenocid, sipas përkufizimit në paragrafin 2 të këtij neni, ose që kryejnë çdo veprim tjetër të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

2. Gjenocid përbën çfarëdo prej veprimeve të mëposhtme, kryer me synimin e asgjësimit tërësor ose të pjesshëm të një grupi kombëtar, etnik, racor ose fetar, si:

- (a) vrasje e anëtarëve të grupit;
- (b) shkaktim i lëndimit të rëndë trupor ose mendor të anëtarëve të grupit;
- (c) imponim ndaj grupit i kushteve të jetesës me synim asgjësimit të fizik, tërësor ose të pjesshëm;
- (d) imponim masash që synojnë parandalimin e lindjeve brenda grupit;
- (e) transferim i dhunshëm i fëmijëve të grupit te një grup tjetër.

3. Veprimet e poshtëpërmendura janë të ndëshkueshme:

- (a) gjenocid;
- (b) komplot për kryerjen e gjenocidit;
- (c) nxitje e drejtpërdrejtë dhe publike për kryerjen e gjenocidit;
- (d) orvatje për kryerjen e gjenocidit;
- (e) bashkëfajësi në gjenocid.

Neni 5 Krimet kundër njerëzimit

Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë përgjegjës për krimet e mëposhtme kur kryhen gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm, dhe të drejtuara kundër çfarëdo popullsie civile:

- (a) vrasje;
- (b) shfarosje;
- (c) robërim;
- (d) dëbim;
- (e) burgim;
- (f) torturë;
- (g) përdhunim;
- (h) përndjekje mbi baza politike, racore dhe fetare;
- (i) veprime të tjera çnjerëzore.

Neni 6 Juridiksioni individual

Tribunali Ndërkombëtar ka juridiksion mbi persona fizikë sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 7 Përgjegjësia penale individuale

1. Një person që ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe ka ndihmuar dhe inkurajuar planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e një krimi të përmendur në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti është individualisht përgjegjës për krimin.

2. Pozita zyrtare e një të akuzuari, qoftë si kryetar shteti apo qeverie ose si zyrtar qeveritar përgjegjës, nuk e çliron atë person nga përgjegjësia penale dhe nuk lehtëson ndëshkimin.

3. Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti u krye prej një vartësi, nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale nëqoftëse ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente ose kishte kryer veprime të tilla dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për ndëshkimin e kryesve të tyre.

4. Fakti që i akuzuari veprimi në bazë të urdhrave të një qeverie ose të një eprori nuk e liron atë nga përgjegjësia penale, por mund të merret parasysh në lehtësimin e ndëshkimit nëqoftëse Tribunali Ndërkombëtar përcakton se këtë e kërkon drejtësia.

Neni 8

Juridiksioni hapësinor dhe kohor

Juridiksioni hapësinor i Tribunalit Ndërkombëtar shtrihet në territorin e ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, duke përfshirë sipërfaqen e saj tokësore, hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale. Juridiksioni kohor i Tribunalit Ndërkombëtar përfshin një periudhë që fillon nga data 1 janar 1991.

Neni 9

Juridiksioni i njëkohshëm

1. Tribunali Ndërkombëtar dhe gjykatat shtetërore kanë juridiksion të njëkohshëm për procedimin penal të individëve për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej 1 janarit të vitit 1991.

2. Tribunali Ndërkombëtar ka përparësi ndaj gjykatave shtetërore. Në çfarëdo faze të procedurës, Tribunali Ndërkombëtar mund të kërkojë zyrtarisht nga gjykatat shtetërore që t'ia kalojnë kompetencën Tribunalit Ndërkombëtar në përputhje me këtë Statut dhe Rregulloren e Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar.

Neni 10

Non-bis-in-idem

1. Asnjë person nuk gjykohet prej një gjykate shtetërore për vepra që përbëjnë shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare sipas këtij Statuti, për të cilat ai tashmë është gjykuar në Tribunalin Ndërkombëtar.

2. Një person që është gjykuar prej një gjykate shtetërore për vepra që përbëjnë shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare mund të gjykohet më vonë prej Tribunalit Ndërkombëtar vetëm nëqoftëse:

- (a) vepra për të cilën ai ose ajo është gjykuar është cilësuar krim i rëndomtë; ose
- (b) procesi gjyqësor shtetëror nuk ishte i paanshëm ose i pavarur, ishte orientuar që të mbronte të akuzuarin prej përgjegjësive penale ndërkombëtare, ose çështja nuk u procedua në mënyrë rrënjësore.

3. Në përcaktimin e dënimit që do t'i jepet një individ të fajësuar për një krim sipas këtij Statuti, Tribunali Ndërkombëtar merr parasysh masën e kryerjes së çfarëdo dënimi të dhënë prej një gjykate shtetërore ndaj të njëjtit individ për të njëjtën veprë.

Neni 11

Organizimi i Tribunalit Ndërkombëtar

Tribunali Ndërkombëtar përbëhet nga këto organe:

- (a) Dhomat, ku përfshihen tri Dhomat Gjyqësore dhe Dhoma e Apelit;
- (b) Prokurori; dhe
- (c) Sekretaria, e cila u shërben si Dhomave po ashtu edhe Prokurorit.

Neni 12 Përbërja e Dhomave

1. Dhomat përbëhen nga jo më shumë se gjashtëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet dhe në çdo moment nga jo më shumë se dymbëdhjetë gjykatës të pavarur *ad litem* të emëruar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 *ter*, të Statutit, çdo dy prej të cilëve nuk janë shtetas të një shteti.

2. Anëtarë të çdo Dhome Gjyqësore janë në çdo kohë jo më shumë se tre gjykatës të përhershëm dhe jo më shumë se gjashtë gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore në të cilën caktohen gjykatës *ad litem*, ndahet në trupa gjykues prej tre gjykatësish secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem* përveç rrethanave të përcaktuara në paragrafin e mëposhtëm 5. Një trup gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

3. Anëtarë të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës të përhershëm. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet nga pesë prej anëtarëve të saj.

4. Një individ i cili në kontekstin e anëtarësisë së Dhomave të Tribunalit Ndërkombëtar mund të konsiderohet si shtetas i më shumë se një shteti, do të konsiderohet shtetas i shtetit në të cilin ai individ ushtron zakonisht të drejtat e tij politike dhe qytetare.

5. Me kërkesë të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar, Sekretari i Përgjithshëm emëron nga gjykatësit *ad litem* të zgjedhur në përputhje me Nenin 13 *ter*, gjykatës rezervë për të qenë të pranishëm në çdo fazë të një procesi gjyqësor ku ata janë emëruar dhe për zëvendësimin e një gjykatësi nëqoftëse ky gjykatës nuk është në gjendje të marrë pjesë.

6. Pa paragjykuar paragrafin e mësipërm 2, në rast se rrethana të veçanta kërkojnë zëvendësimin e një gjykatësi të përhershëm të një trupi gjykues duke rezultuar në një trup gjykues të përbërë vetëm prej gjykatësve *ad litem*, ky trup gjykues mund të vazhdojë me çështjen gjyqësore, pavarësisht se nuk ka asnjë gjykatës të përhershëm në përbërje.

Neni 13 Kualifikimet e gjykatësve

1. Gjykatësit e përhershëm dhe *ad litem* duhet të jenë individë me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm të cilët kanë kualifikimet e kërkuara në vendet e tyre përkatëse për t'u emëruar në postet më të larta gjyqësore. Në përbërjen e përgjithshme të Dhomave dhe trupave gjykues, merret parasysh përvoja e gjykatësve në të drejtën penale dhe në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Neni 13 bis Zgjedhja e gjykatësve të përhershëm

1. Katërmëdhjetë prej gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme prej një liste të paraqitur nga Këshilli i Sigurimit, në këtë mënyrë:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionë vëzhgues të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara që të paraqesin kandidatura për gjykatës në Tribunalin Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditëve pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të propozojë jo më shumë se dy kandidatë të cilët plotësojnë kushtet e parashtruara në nenin 13 të Statutit, nuk kanë të njëjtën shtetësi, dhe asnjëri prej të cilëve nuk ka shtetësinë e ndonjë gjykatësi i cili është anëtar i Dhomës së Apelit dhe është zgjedhur ose emëruar gjykatës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe të Qytetarëve të Ruandës Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje prej 1 janarit 1994 deri më 31 dhjetor 1994 (më tej i quajtur "Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën") në përputhje me Nenin 12 *bis* të Statutit të atij Tribunali.

- (c) Emrat e propozuar, Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell Këshillit të Sigurimit. Prej propozimeve të marra, Këshilli i Sigurimit përpilon një listë me jo më pak se njëzetetë dhe jo më shumë se dyzetëdy kandidatë, duke i kushtuar vëmendje përfaqësimit të mjaftueshëm të sistemeve kryesore juridike në botë.
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme zgjedh prej kësaj liste katërmëdhjetë gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar. Do të shpallen të zgjedhur kandidatët të cilët marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionë vëzhguesë të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se dy kandidatë me të njëjtën shtetësi marrin shumicën e nevojshme të votave, do të shpallet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

2. Po të mbetet ndonjë post i zbrazët në Dhoma, ndër gjykatësit e përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me këtë nen, pas konsultimeve me Kryetarin e Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm emëron për pjesën e mbetur të mandatit përkatës një person i cili përmbush kushtet sipas Nenit 13 të Statutit.

3. Gjykatësit e përhershëm të zgjedhur në përputhje me këtë nen zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Kushtet e shërbimit të tyre janë si ato të gjykatësve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

Neni 13 ter **Zgjedhja dhe emërimi i gjykatësve *ad litem***

1. Gjykatësit *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen prej Asamblesë së Përgjithshme nga një listë e paraqitur prej Këshillit të Sigurimit në mënyrën e mëposhtme:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguesë pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara, që të paraqesin kandidatura për gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditësh pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të caktojë deri në katër kandidatë të cilët përmbushin cilësitë e përcaktuara në nenin 13 të Statutit, duke mbajtur parasyh një përfaqësim të balancuar të kandidatëve femra dhe meshkuj;
- (c) Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell emrat e propozuar Këshillit të Sigurimit. Prej emrave të propozuar Këshilli i Sigurimit përcakton një listë prej jo më pak se pesëdhjetekatër kandidatësh, duke i kushtuar vëmendjen e duhur përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë dhe duke mbajtur parasyh shpërndarjen e barabartë gjeografike;
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Prej kësaj liste Asambleja e Përgjithshme zgjedh njëzeteshtatë gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar. Kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguesë pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara deklarohen të zgjedhur;
- (e) Gjykatësit *ad litem* deklarohen të zgjedhur për një mandat katërvjeçar. Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

2. Gjatë çfarëdo mandati, gjykatësit *ad litem* emërohen prej Sekretarit të Përgjithshëm pas kërkesës së Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për të shërbyer në Dhoma Gjyqësore në një ose më shumë procese gjyqësore për një periudhë përmbledhëse deri në tri vjet, por jo saktësisht tri vjet. Në kërkesën për emërimin e një gjykatësi *ad litem*, Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar mban parasyh kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Statutit në lidhje me përbërjen e Dhomave dhe trupave gjyqësore të Dhomave Gjyqësore, përcaktimet e parashtruara në paragrafin 1 (b) dhe (c) më lart dhe numrin e votave që gjykatësi *ad litem* merr në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 13 quater **Statusi i gjykatësve *ad litem***

1. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) Përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit *mutadis mutandis* si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;

- (b) Varësisht prej paragrafit të mëposhtëm 2 gëzojnë të njëjtat kompetenca si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (c) Gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (d) Gëzojnë kompetencë të procedojnë në procedura paragjyqësore në çështje të tjera veç atyre që janë emëruar për të gjykuar.

2. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) nuk kanë të drejtë të zgjidhen ose të zgjedhin Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar apo Kryegjykatësin e një Dhoma Gjyqësore bazuar në Nenin 14 të Statutit;
- (b) nuk kanë kompetencë:
 - (i) që të miratojnë rregullore procedurash dhe provash sipas nenit 15 të Statutit. Gjithsesi ata këshillohen para miratimit të këtyre rregulloreve;
 - (ii) që të shqyrtojnë një aktakuzë sipas nenit 19 të Statutit;
 - (iii) që të këshillohen me Kryetarin në lidhje me caktimin e gjykatësve sipas nenit 14 të Statutit, ose në lidhje me një falje ose ndryshim të dënimit sipas nenit 28 të Statutit.

3. Pavarësisht paragrafëve të mësipërm 1 dhe 2, gjykatësit *ad litem* që shërbejnë si gjykatës rezervë:

- (a) Përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit mutadis mutandis si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (b) Gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit ndërkombëtar;
- (c) Gëzojnë kompetencë të gjykojnë në procedura paragjyqësore në çështje të tjera veç atyre që janë emëruar për të gjykuar.

4. Në rast se një gjykatës rezervë zëvendëson një gjykatës që nuk mund të vazhdojë të marrë pjesë, gjatë asaj periudhe ai ose ajo do të përfitojë prej dispozitave të paragarit të mësipërm 1.

Neni 14

Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave

1. Gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar zgjedhin Kryetarin nga radhët e veta.

2. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar është anëtar i Dhomës së Apelit dhe kryeson punimet e saj.

3. Pas konsultimeve me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomën e Apelit katër gjykatës të përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 13 *bis* të Statutit dhe nëntë syresh në Dhomat Gjyqësore.

4. Dy gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 12 *bis* të Statutit të atij Tribunali caktohen nga Kryetari i atij Tribunali, në konsultim me Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar, që të jenë anëtarë të Dhomës së Apelit dhe gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar.

5. Pas konsultimit me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomat Gjyqësore ata gjykatës *ad litem* që emërohen herë pas here për të shërbyer në Tribunalin Ndërkombëtar.

6. Gjykatësi shërben vetëm në Dhomën ku ai ose ajo është caktuar.

7. Gjykatësit e përhershëm të secilës Dhomë Gjyqësore zgjedhin një Kryegjykatës nga radhët e veta, i cili mbikëqyr në tërësi punën e Dhomës Gjyqësore.

Neni 15

Rregullorja e Procedurës dhe e Provave

Gjykatësit e Tribunalit Ndërkombëtar miratojnë një rregullore të procedurës dhe të provave për kryerjen e fazës paragjyqësore, gjykimit dhe apelit, pranimin e provave, mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve dhe të çështje të tjera përkatëse.

Neni 16 Prokurori

1. Prokurori është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë prej 1 janarit të vitit 1991.

2. Prokurori vepron në mënyrë të pavarur si organ i veçantë i Tribunalit Ndërkombëtar. Ai/ajo nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.

3. Zyra e Prokurorit përbëhet nga prokurori dhe, sipas nevojës, nga personel tjetër i kualifikuar.

4. Prokurori emërohet nga Këshilli i Sigurimit pas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm. Ai ose ajo duhet të jetë me karakter të lartë moral dhe të ketë nivelin më të lartë të aftësisë dhe të përvojës në kryerjen e hetimeve dhe procedimin e çështjeve penale. Prokurori shërben për një mandat katërvjeçar dhe ka të drejtë të riemërohet. Kushtet e shërbimit të prokurorit janë si ato të një Nënsekretari të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. Personeli i Zyrës së Prokurorit emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm me rekomandim të Prokurorit.

Neni 17 Sekretaria

1. Sekretaria është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimet për Tribunalin.

2. Sekretaria përbëhet nga Sekretari dhe personel tjetër sipas nevojës.

3. Sekretari emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm pas konsultimit me Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar. Ai ose ajo shërben për një mandat katërvjeçar dhe gëzon të drejtën e riemërimit. Kushtet e shërbimit të Sekretarit do të jenë si ato të një Ndhmëssekretari të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

4. Personeli i Sekretarisë emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm me rekomandim të Sekretarit.

Neni 18 Hetimi dhe përgatitja e aktakuzës

1. Prokurori fillon hetime *ex officio* ose në bazë të të dhënave marrë nga çfarëdo burimi, veçanërisht prej qeverive, organeve të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave ndërqeveritare dhe joqeveritare. Prokurori vlerëson të dhënat e marra ose të siguruar dhe vendos nëse ekziston bazë e mjaftueshme për të proceduar.

2. Prokurori ka kompetencë për marrjen në pyetje të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve, për mbledhjen e provave dhe për kryerjen e hetimeve në terren. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave, Prokurori mund të kërkojë ndihmën e autoriteteve të shtetit përkatës sipas nevojës.

3. Nëqoftëse merret në pyetje, i dyshuari ka të drejtë të ndihmohet prej një avokati të zgjedhur prej tij, përfshirë të drejtën që t'i caktohet ndihmë juridike pa pagesë në qoftë se atij i mungojnë fondet e mjaftueshme për të paguar, si edhe përktimi i nevojshëm në një gjuhë dhe prej një gjuhe që ai e flet dhe e kupton.

4. Pasi konstaton se ekziston një çështje *prima facie*, Prokurori përgatit aktakuzën që përfshin një përshkrim të shkurtër të fakteve dhe të krimit ose krimeve për të cilat akuzohet i akuzuari në bazë të Statutit. Aktakuza i përcillet një gjykatësi të Dhomës Gjyqësore.

Neni 19 Shqyrtimi i aktakuzës

1. Gjykatësi i Dhomës Gjyqësore, të cilit i është përcjellë aktakuza, e shqyrton atë. Nëqoftëse bindet se prokurori ka provuar çështjen *prima facie*, gjykatësi e konfirmon aktakuzën. Nëqoftëse nuk bindet për këtë, e hedh poshtë aktakuzën.

2. Pas konfirmimit të aktakuzës, me kërkesë të Prokurorit, gjykatësi mund të lëshojë urdhra dhe autorizime për arrestimin, paraburgimin, dorëzimin ose transferimin e individëve dhe çfarëdo urdhrash të tjerë që mund të jenë të nevojshëm për zhvillimin e procesit gjyqësor.

Neni 20

Fillimi dhe zhvillimi i procesit gjyqësor

1. Dhomat Gjyqësore garantojnë gjykim të drejtë dhe të shpejtë dhe një zhvillim të procesit në përputhje me rregulloren e procedurës dhe të provave, duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarve dhe duke i kushtuar vëmendjen e duhur mbrojtjes së viktimave dhe të dëshmitarëve.

2. Në bazë të një urdhërese ose një fletarrestimi të Tribunalit Ndërkombëtar, individi kundër të cilit është konfirmuar një aktakuzë, arrestohet, informohet menjëherë për akuzat kundër tij dhe transferohet menjëherë në Tribunalin Ndërkombëtar.

3. Dhoma Gjyqësore e lexon aktakuzën, sigurohet se janë respektuar të drejtat e të akuzuarit, konfirmon se i akuzuari e kupton aktakuzën dhe e udhëzon atë që të deklarohet për fajësinë ose pafajësinë. Më pas Dhoma Gjyqësore cakton një datë për gjykimin.

4. Seancat janë publike përveç rasteve kur Dhoma Gjyqësore vendos ta mbyllë seancën për publikun në përputhje me rregulloren e procedurës dhe të provave.

Neni 21

Të drejtat e të akuzuarit

1. Të gjithë individët janë të barabartë para Tribunalit Ndërkombëtar.

2. Në vërtetimin e akuzave kundër tij, i akuzuari gëzon të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, në varësi të Nenit 22 të Statutit.

3. I akuzuari konsiderohet i pafajshëm deri në vërtetimin e fajësisë së tij sipas dispozitave të këtij Statuti.

4. Në vërtetimin e çdo akuze kundër të akuzuarit në bazë të këtij Statuti, i akuzuari ka të drejtën e këtyre garancive minimale, në barazi të plotë:

- (a) të informohet në kohë dhe në hollësi, në një gjuhë që ai e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;
- (b) të ketë kohë dhe kushte të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të komunikojë me avokatin që ka zgjedhur vetë;
- (c) të gjykohet pa vonesa të panevojshme;
- (d) të jetë i pranishëm në gjykimin kundër tij; të mbrohet vetë ose me anë të avokatit që e ka zgjedhur vetë; të informohet për këtë të drejtë, në qoftë se nuk ka ndihmë juridike; dhe në qoftë se e kërkojnë interesat e drejtësisë, t'i caktohet ndihmë juridike pa pagesë nëqoftëse nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar;
- (e) të marrë në pyetje, ose të kërkojë të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në mbrojtje të tij në kushte të njëjta si dëshmitarët kundër tij;
- (f) të ketë ndihmën pa pagesë të përkthyesit në qoftë se nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur në Tribunalin Ndërkombëtar;
- (g) të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë.

Neni 22

Mbrojtja e viktimave dhe e dëshmitarëve

Në rregulloren e vetë të procedurës dhe provave Tribunali Ndërkombëtar përcakton mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve. Ndër masa të tilla mbrojtëse përfshihet mbajtja e seancave të mbyllura dhe mbrojtja e identitetit të viktimës.

Neni 23 **Aktgjykimi**

1. Dhomat Gjyqësore shqiptojnë aktgjykime dhe dënime kundër individëve të fajësuar për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

2. Aktgjykimi jepet nga shumica e gjykatësve të Dhomës Gjyqësore dhe shpallet publikisht nga Dhoma Gjyqësore. Aktgjykimi shoqërohet me një arsyetim me shkrim, të cilit mund t'i bashkëngjiten mendime të veçanta ose mospajtuese.

Neni 24 **Përcaktimi i Dënimit**

1. I vetmi dënim që jep Dhoma Gjyqësore është burgimi. Në përcaktimin e kushteve të burgimit, Dhomat Gjyqësore i referohen praktikës së përgjithshme të dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë

2. Gjatë përcaktimit të dënimit, Dhomat Gjyqësore duhet të mbajnë parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat individuale të fajtorit.

3. Përveç burgimit, Dhomat Gjyqësore mund të urdhërojnë që pronarëve të ligjshëm t'u kthehet çdo pronë ose fitim siguruar nëpërmjet veprimeve kriminale, ndër të tjera nëpërmjet shtrëngimit.

Neni 25 **Procedura e Apelit**

1. Dhoma e Apelit shqyrton apelimet prej individëve të fajësuar nga Dhomat Gjyqësore ose prej Prokurorit, mbi këto baza:

- (a) gabim ligjor që e shfuqizon vendimin; ose
- (b) gabim faktual i cili ka shkaktuar dështim të drejtësisë.

2. Dhoma e Apelit mund të konfirmojë, të shfuqizojë, ose të ndryshojë vendimet e marra nga Dhomat Gjyqësore.

Neni 26 **Procedura e rishqyrtimit**

Kur zbulohet një fakt i ri, i cili nuk njihej në kohën e procesit në Dhomat Gjyqësore ose në Dhomën e Apelit, dhe i cili mund të kishte qenë faktor përcaktues në marrjen e vendimit, i fajësuari ose Prokurori mund t'i bëjë Tribunalit kërkesë për rishqyrtimin e aktgjykimit.

Neni 27 **Zbatimi i dënimeve**

Burgimi kryhet në një shtet të caktuar prej Tribunalit Ndërkombëtar nga një listë shtetesh që i kanë shprehur Këshillit të Sigurimit gatishmërinë për pranimin e individëve të dënuar. Burgimi zbatohet në përputhje me ligjin në fuqi në shtetin përkatës, nën mbikëqyrjen e Tribunalit.

Neni 28 **Falja ose ulja e dënimeve**

Nëqoftëse, në bazë të ligjit në fuqi në shtetin ku i dënuari kryen burgimin, ai ose ajo plotëson kushtet për faljen ose ndryshimin e dënimit, shteti përkatës njofton Tribunalin. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar, në konsultim me gjykatësit, vendos për çështjen në bazë të interesave të drejtësisë dhe të parimeve të përgjithshme ligjore.

Neni 29
Bashkëpunimi dhe ndihma juridike

1. Shtetet bashkëpunojnë me Tribunalin Ndërkombëtar në hetimin dhe ndjekjen penale të individëve të akuzuar për kryerjen e shkeljeve të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

2. Shtetet përmbushin pa vonesë të panevojshme çdo kërkesë për ndihmë ose urdhër të lëshuar nga një Dhomë Gjyqësore, ndër të tjera në lidhje me:

- (a) identifikimin dhe gjetjen e individëve;
- (b) marrjen e dëshmive dhe paraqitjen e provave;
- (c) dorëzimin e dokumenteve;
- (d) arrestimin ose paraburgimin e individëve;
- (e) dorëzimin ose transferimin e të akuzuarve në Tribunalin Ndërkombëtar.

Neni 30
Statusi, privilegjet dhe imunitetet e Tribunalit Ndërkombëtar

1. Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara e datës 13 shkurt 1946 vlen për Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit, Prokurorin dhe personelin e tij, si dhe për Sekretarin dhe personelin e tij.

2. Gjykatësit, Prokurori dhe Sekretari gëzojnë privilegjet, imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat që u akordohen të dërguarve diplomatikë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

3. Personeli i Prokurorit dhe i Sekretarit gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që u akordohen zyrtarëve të Kombeve të Bashkuara sipas neneve V dhe VII të Konventës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Individëve të tjerë, duke përfshirë të akuzuarit, prania e të cilëve nevojitet në selinë e Tribunalit Ndërkombëtar, iu akordohet trajtimi i nevojshëm për funksionimin e rregullt të Tribunalit Ndërkombëtar.

Neni 31
Selia e Tribunalit Ndërkombëtar

Tribunali Ndërkombëtar e ka selinë në Hagë.

Neni 32
Shpenzimet e Tribunalit Ndërkombëtar

Shpenzimet e Tribunalit Ndërkombëtar mbulohen nga buxheti i rregullt i Kombeve të Bashkuara në përputhje me Nenin 17 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 33
Gjuhët e punës

Gjuhët e punës së Tribunalit Ndërkombëtar janë anglishtja dhe frengjishtja.

Neni 34
Raporti vjetor

Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar u paraqet Këshillit të Sigurimit dhe Asamblesë së Përgjithshme një raport vjetor të Tribunalit Ndërkombëtar.

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/808 (1993)
22 shkurt 1993

REZOLUTA 808 (1993)

Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 3175
më 22 shkurt 1993

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutën e tij 713 (1991) të 25 shtatorit 1991 dhe të tëra rezolutat përkatëse vijuese.

Duke kujtuar paragrafin 10 të rezolutës së tij 764 (1992) të 13 korrikut 1992 ku riafirmoi se të tëra palët janë të detyruara të përmbushin detyrimet që burojnë prej të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe në veçanti Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe se personat që kryejnë ose urdhërojnë kryerjen e shkeljeve të rënda të komventave janë individualisht përgjegjës për këto shkelje.

Duke kujtuar gjithashtu rezolutën e vetë 771 (1992) të 13 gushtit 1992 ku ndër të tjera kërkoi që të tëra palët dhe të interesuarit të tjerë në ish-Jugosllavi dhe të gjitha forcat ushtarake në Bosnjë dhe Hercegovinë menjëherë të ndalojnë dhe të tërhiqen nga kryerja e çdo shkeljeve të se drejtës humanitare ndërkombëtare,

Duke kujtuar më tej rezolutën e vetë 780 (1992) të 6 tetorit 1992 ku Sekretarit të Përgjithshëm iu kërkua që të formonte urgjentisht një Komision të paanshëm Ekspertësh për shqyrtimin dhe analizimin e informacionit të paraqitur sipas rezolutave 771 (1992) dhe 780 (1992), si dhe informacion tjetër që mund të sigurohet prej Komisionit të Ekspertëve, me synim që Sekretarit të Përgjithshëm t'i ofrohen përfundimet e Komisionit bazuar në provat e shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës dhe shkelje të tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare kryer në territorin e ish-Jugosllavisë,

Pasi ka shqyrtuar raportin paraprak të Komisionit të Ekspertëve themeluar prej rezolutës 780 (1992) (S/25274) ku Komisioni konstatoi se vendimi për ngritjen e një tribunali ndërkombëtar ad hoc për ngjarjet në territorin e ish-Jugosllavisë do të ishte në pajtim me synimin e veprimtarisë së tij,

Duke shprehur edhe një herë shqetësimin e vetë të rëndë në lidhje me raportet e vazhdueshme të shkeljeve të gjithanshme të së drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë, ndër të cilat edhe raporte për vrasje masive dhe vazhdimin e praktikës së "spastrimit etnik",

Duke përcaktuar se këto rrethana përbëjnë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,

I vendosur për t'u dhënë fund këtyre krimeve dhe për marrjen e masave efektive për nxjerrjen para drejtësisë së personave përgjegjës.

I bindur se në rrethanat e përcaktuara të ish-Jugosllavisë themelimi i një tribunali ndërkombëtar do të mundësonte arritjen e këtij synimi dhe do të kontribuonte në kthimin dhe ruajtjen e paqes,

Duke marrë shënim në këtë aspekt rekomandimin e Bashkëkryetarëve të Komitetit Drejtues në Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për themelimin e një tribunali të tillë (S/25221),

Duke marrë gjithashtu shënim me shqetësim të thellë “raportin e misionit hetues të Bashkësisë Evropiane për trajtimin e grave muslimane në ish-Jugosllavi” (S/25240, Shtojca 1),

Duke marrë shënim më tej raportin e komitetit të juristëve paraqitur nga Franca (S/25266), raportin e komitetit të juristëve paraqitur nga Italia (S/25300), dhe raportin e përcjellë nga Përfaqësuesi i Përhershëm i Suedisë në Emët të Kryetarit të Radhës së Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian (OSBE) (S/25307),

1. Vendos të themelojë një tribunal ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991;

2. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm t’i paraqesë për shqyrtim Këshillit sa më shpejt dhe nëse është e mundur jo më vonë se 60 ditë pas miratimit të kësaj rezolute, një raport për të tëra aspektet e çështjes ku të përfshihen propozime konkrete dhe po të jetë e përshtatshme opsione për zbatimin efektiv dhe të shpejtë të vendimit që përfshihet në paragrafin e mësipërm 1, duke marrë parasysh sugjerimet e paraqitura nga shtetet anëtarë;

3. Vendos të mbetet aktivisht i angazhuar me çështjen:

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/827 (1993)
25 maj 1993

REZOLUTA 827 (1993)

Miraturar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 3217
më 25 maj 1993

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutën e tij 713 (1991) të 25 shtatorit 1991 dhe të tëra rezolutat përkatëse vijuese,

Pasi ka shqyrtuar raportin e Sekretarit të Përgjithshëm (S/25704 dhe Shtojcën.1) bazuar në paragrafin 2 të rezolutës 808 (1993),

Duke shprehur edhe një herë shqetësimin e vetë të rëndë në lidhje me raportet e vazhdueshme të shkeljeve të gjithanshme dhe të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e ish-Jugosllavisë, ndër të cilat edhe raporte për vrasje masive ndalime dhe përdhunime masive të organizuara dhe sistematike të grave dhe vazhdimin e praktikës së “spastrimit etnik”, ku përfshihet edhe marrja dhe mbajtja e territorit,

Duke përcaktuar se këto rrethana përbëjnë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,

I vendosur për t’u dhënë fund këtyre krimeve dhe për marrjen e masave efektive për nxjerrjen para drejtësisë së personave përgjegjës,

I bindur se në rrethanat e veçanta të ish-Jugosllavisë themelimi i një tribunali ndërkombëtar si masë ad hoc prej Këshillit do të mundësonte arritjen e këtij synimi dhe do të kontribuonte në kthimin dhe ruajtjen e paqes,

Me besimin se themelimi i një tribunali ndërkombëtar dhe ndjekja penale e individëve përgjegjës për shkeljet e lartpërmendura të së drejtës humanitare ndërkombëtare do të mundësojnë ndërprerjen e këtyre shkeljeve dhe zhdëmtim efektiv,

Duke marrë shënim në këtë aspekt rekomandimin e Bashkëkryetarëve të Komitetit Drejtues në Konferencën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për themelimin e një tribunali të tillë (S/25221),

Duke riafirmuar në lidhje me këtë vendimin e vet në rezolutën 808 (1993) për themelimin e një tribunali ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991,

Duke marrë parasysh se në pritje të emërimit të Prokurorit të Tribunalit Ndërkombëtar, Komisioni i Ekspertëve i formuar në bazë të rezolutës 780 (1992) duhet të vazhdojë me urgjencë mbledhjen e informatave në lidhje me prova të shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës dhe shkelje të tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare propozuar në raportin e vet paraprak (S/25274),

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kombeve të Bashkuara,

1. Miraton raportin e Sekretarit të Përgjithshëm;

2. Vendos themelimin e një tribunali ndërkombëtar me synimin e vetëm të ndjekjes penale të personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej 1 janarit 1991 deri në një datë që do të përcaktohet prej Këshillit të Sigurimit pas kthimit të paqes dhe për këtë qëllim miraton Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar bashkëngjitur raportit të lartpërmendur;

3. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm t'u paraqesë gjykatësve të Tribunalit Ndërkombëtar pas zgjedhjes së tyre, çfarëdo sugjerimi të marrë nga shtetet për rregulloren e procedurës dhe provave përmendur në Nenin 15 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar;

4. Vendos që të gjithë shtetet të bashkëpunojnë plotësisht me Tribunalin Ndërkombëtar dhe organet e tij në përputhje me këtë rezolutë dhe Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar dhe se si rezultat të gjithë shtetet të marrin çdo masë të nevojshme në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj rezolute dhe Statutit, duke përfshirë detyrimin e shteteve për plotësimin e kërkesave për ndihmë ose urdhëresave të lëshuara prej një Dhome Gjyqësore sipas Nenit 29 të Statutit;

5. Nxit shtetet dhe organizatat ndërqeveritare dhe joqeveritare të ofrojnë fonde, pajisje dhe shërbime për Tribunalin Ndërkombëtar përfshirë edhe personel ekspert;

6. Vendos që caktimi i selisë së Tribunalit Ndërkombëtar të kushtëzohet prej përfundimit të masave të përshtatshme midis Kombeve të Bashkuara dhe Holandës të pranueshme për Këshillin dhe se Tribunali Ndërkombëtar mund të vendoset diku tjetër nëqoftëse e gjykon të nevojshme për ushtrimin efektiv të funksioneve të veta;

7. Gjithashtu vendos që puna e Tribunalit Ndërkombëtar të kryhet pa paragjykim ndaj të drejtës së viktimave për të kërkuar përmes masave të përshtatshme, kompensim për dëmin e shkaktuar si rezultat i shkeljeve të së drejtës humanitare ndërkombëtare;

8. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të zbatojë urgjentisht këtë rezolutë dhe veçanërisht të përcaktojë masat praktike për funksionimin efektiv të Tribunalit Ndërkombëtar sa më shpejt dhe t'i raportojë Këshillit periodikisht;

9. Vendos të mbetet i angazhuar aktivisht me çështjen:

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/827 (1993)
13 maj 1998

REZOLUTA 1166 (1998)

Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 3878
më 13 maj 1998

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutën e tij 827 (1993) të 25 majit 1993,

Duke mbetur i bindur se ndjekja penale e personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë kontribuon për kthimin dhe ruajtjen e paqes në ish-Jugosllavi,

Pasi ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 5 maj 1998 (S/1998/378),

I bindur për nevojën e rritjes së numrit të gjykatësve dhe Dhomave Gjyqësore për t'i mundësuar Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 ("Tribunali Ndërkombëtar") që të gjykojë pa vonesë të akuzuarit e shumë të gjykohen,

Duke marrë shënim përparimin e dukshëm në përmirësimin e procedurave të Tribunalit Ndërkombëtar dhe i bindur mbi nevojën që organet e veta të vazhdojnë përpjekjet drejt përparimit të mëtejshëm,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos të krijojë një Dhomë të tretë Gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar dhe për këtë qëllim vendos të ndryshojë nenet 11, 12 dhe 13 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar dhe t'i zëvendësojë këto nene me dispozitat e paraqitura në shtojcën e kësaj rezolute;

2. Vendos që të zgjidhen sa më shpejt tre gjykatës shtesë që do të shërbejnë në Dhomën e shtuar Gjyqësore dhe gjithashtu vendos, pa paragjykuar nenin 13.4 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar se pasi të jenë zgjedhur, ata do të jenë në detyrë deri në datën e mbarimit të mandatit të gjykatësve ekzistues dhe se për hir të kësaj zgjedhjeje, pavarësisht nenit 13.2(c) të Statutit, Këshilli i Sigurimit të përcaktojë një listë prej kandidatëve të propozuar me jo më pak se gjashtë dhe jo më shumë se nëntë emra;

3. Nxit të gjithë shtetet që të bashkëpunojnë plotësisht me Tribunalin Ndërkombëtar dhe organet e tij në përputhje me detyrimet e tyre sipas rezolutës 827 (1993) dhe Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar dhe përsëritet bashkëpunimin e ofruar Tribunalit në përmbushjen e misionit të tij;

4. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat praktike për zgjedhjen e përmendur në paragrafin e mësipërm 2 dhe për fuqizimin e funksionimit efektiv të Tribunalit Ndërkombëtar ku përfshihen edhe vënia në dispozicion e burimeve njerëzore dhe materiale veçanërisht për Dhomën e tretë Gjyqësore dhe zyrat përkatëse të

Prokurorit dhe më tej kërkon që ai ta mbajë vazhdimisht të informuar Këshillin e Sigurimit për përparimin në këtë aspekt;

5. Vendos të mbetet aktivisht i angazhuar me çështjen:

SHTOJCË

Neni 11 Organizimi i Tribunalit Ndërkombëtar

Tribunali Ndërkombëtar përbëhet nga këto organe:

- (a) Dhomat, ku përfshihen tri Dhomat Gjyqësore dhe Dhoma e Apelit;
- (b) Prokurori; **dhe**
- (c) Sekretaria, **e cila u shërben si Dhomave po ashtu edhe Prokurorit.**

Neni 12 Përbërja e Dhomave

Dhomat përbëhen prej katërmbëdhjetë gjykatësve të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të njëjtit shtet, të cilët shërbejnë si vijon:

- (a) tre gjykatës shërbejnë në çdo Dhomë Gjyqësore ; dhe
- (b) **pesë gjykatës shërbejnë në Dhomën e Apelit.**

Neni 13 Kualifikimet dhe zgjedhja e gjykatësve

1. Gjykatësit duhet të jenë individë me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm që kanë kualifikimet e kërkuara në vendet e tyre përkatëse për t'u emëruar në postet më të larta juridike. Në përbërjen e përgjithshme të Dhomave, merret parasysh përvoja e gjykatësve në të drejtën penale dhe në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

2. Gjykatësit e Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme prej një liste të paraqitur nga Këshilli i Sigurimit, në këtë mënyrë:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara që të paraqesin kandidatura për gjykatës në Tribunalin Ndërkombëtar.
- (b) **Brenda gjashtëdhjetë ditëve pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të propozojë më së shumti dy kandidatë që i plotësojnë kushtet e parashtruara në paragrafin e mësipërm 1 që nuk kanë të njëjtën shtetësi.**
- (c) **Emrat e propozuar, Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell Këshillit të Sigurimit. Prej propozimeve të marra, Këshilli i Sigurimit përpilon një listë me jo më pak se njëzet e tetë dhe jo më shumë se dyzetedy kandidatë, duke i kushtuar kujdes përfaqësimit të mjaftueshëm të sistemeve kryesore juridike në botë.**
- (d) **Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme zgjedh prej kësaj liste katërmbëdhjetë gjykatës të Tribunalit Ndërkombëtar. Do të shpallen të zgjedhur kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara. Nëqoftëse dy kandidatë me të njëjtën shtetësi marrin shumicën e nevojshme të votave, do të shpallet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.**

3. Po të mbetet ndonjë post i zbrazët në Dhoma, pas konsultimeve me Kryetarin e Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm emëron për pjesën e mbetur të mandatit përkatës një person që përmbush kushtet e paragrafit të mësipërm 1.

4. Gjykatësit zgjidhen për një mandat katërveçar. Kushtet e shërbimit të tyre janë si ato të gjykatësve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1329 (2000)
30 nëntor 2000

REZOLUTA 1329 (2000)

Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4240
më 30 nëntor 2000

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993 dhe 955 (1994) të 8 nëntorit 1994,

Duke qenë i bindur se ndjekja penale e personave përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë kontribuon për kthimin dhe ruajtjen e paqes në ish-Jugosllavi,

Duke qenë gjithashtu i bindur se në rrethanat e veçanta të Ruandës, ndjekja penale e personave përgjegjës për gjenocid dhe shkelje të tjera të rënda të së drejtës humanitare kontribuon në procesin e pajtimit kombëtar dhe në kthimin dhe ruajtjen e paqes në Ruandë dhe në rajon,

Pasi ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 7 shtator 2000 (S/2000/865) dhe letrat e bashkëngjitura të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për Sekretarin e Përgjithshëm të datës 12 maj 2000 dhe të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën të datës 14 qershor 2000,

I bindur për nevojën e krijimit të një grupi gjykatësish *ad litem* në Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe për shtimin e numrit të gjykatësve në Dhomat e Apelit të Tribunalëve Ndërkombëtarë për t'u mundësuar Tribunalëve Ndërkombëtarë që të përshpejtojnë përfundimin e punës së tyre sa më shpejt që të jetë e mundur,

Duke konstatuar përparimin e dukshëm në përmirësimin e procedurave të Tribunalëve Ndërkombëtarë dhe i bindur mbi nevojën që organet e tyre të vazhdojnë përpjekjet drejt përparimit të mëtejshëm,

Duke marrë shënim qëndrimin e shprehur prej Tribunalëve Ndërkombëtarë se ata duhet të gjykojnë udhëheqësit civilë, ushtarakë dhe paraushtarakë në vend të individëve më pak të rëndësishëm,

Duke kujtuar se Tribunalët Ndërkombëtar dhe gjykatat shtetërore kanë juridiksion të njëkohshëm për ndjekjen penale të personave për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe duke konstatuar se Rregullorja e Procedurës dhe Provave të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë përcakton se një Dhomë Gjyqësore mund të vendosë që të pezullojë një aktakuzë për t'i mundësuar një gjykatë shtetërore që të procedojë me një çështje të caktuar,

Duke konstatuar me mirënjohje përpjekjet e gjykatësve të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë pasqyruar në shtojcën I të letrës së Sekretarit të Përgjithshëm të 7 shtatorit 2000, që u mundëson organeve të Kombeve të Bashkuara që të fillojnë dhe krijojnë një ide relativisht të saktë të kohëzgjatjes së mandatit të Tribunalit,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos të krijojë një grup gjykatësish *ad litem* në Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe të zgjerojë anëtarësinë e Dhomave të Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe të Tribunalit

Ndërkombëtar për Ruandën dhe për këtë qëllim vendos të ndryshojë nenet 12, 13 dhe 14 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe t'i zëvendësojë këto nene me dispozitat e paraqitura në shtojcën I të kësaj rezolute dhe gjithashtu vendos të ndryshojë nenet 11, 12 dhe 13 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe t'i zëvendësojë këto nene me dispozitat e paraqitura në shtojcën 2 të kësaj rezolute;

2. Vendos që të zgjidhen sa më shpejt që të jetë e mundur dy gjykatës shtesë si gjykatës të Tribunalit Ndërkombëtar të Ruandës dhe gjithashtu vendos pa paragjykuar paragrafin 4 të nenit 12 të Statutit të këtij Tribunali që pas zgjedhjes ata të shërbejnë deri në datën e përfundimit të mandatit të gjykatësve ekzistues dhe se në lidhje me këtë zgjedhje, Këshilli i Sigurimit, pavarësisht paragrafit 2 (c) të Nenit 12 të Statutit, të përcaktojë një listë prej emrave të propozuar me jo më pak se katër dhe jo më shumë se gjashtë kandidatë;

3. Vendos që pas zgjedhjes së dy gjykatësve në përputhje me paragrafin e mësipërm 2 dhe fillimit të detyrës prej tyre, Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën në përputhje me paragrafin 3 të Nenit 13 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe paragrafin 4 të Nenit 14 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë sa më shpejt që të jetë e mundur të marrë masat e nevojshme për caktimin e dy prej gjykatësve të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 12 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën si anëtarë të Dhomave të Apelit të Tribunalëve Ndërkombëtarë;

4. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat praktike për zgjedhjet e përmendura në paragrafin e mësipërm 2 për zgjedhjen sa më shpejt të njëzeteshtatë gjykatësve *ad litem* në përputhje me Nenin 13 *ter* të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe për vënien në dispozicion në kohë të burimeve njerëzore dhe materiale për Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën, në veçanti për gjykatësit *ad litem* dhe Dhomat e Apelit dhe zyrat përkatëse të Prokurorit dhe më tej kërkon që ai ta mbajë vazhdimisht të informuar Këshillin e Sigurimit për përparimin në këtë aspekt;

5. Nxit të gjithë shtetet që të bashkëpunojnë plotësisht me Tribunalët Ndërkombëtarë dhe organet e tyre në përputhje me detyrimet e tyre sipas rezolutave 827 (1993) dhe 955 (1994) dhe Statutet e Tribunalëve Ndërkombëtarë dhe *përshëndet* bashkëpunimin e ofruar Tribunalëve në përmbushjen e misionëve të tyre;

6. Kërkon që Sekretari i Përgjithshëm t'i paraqesë sa më shpejt Këshillit të Sigurimit një raport ku të përfshihen vlerësimi dhe propozime në lidhjen me datën e mbarimit të juridiksionit kohor të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;

7. Vendos të mbetet i angazhuar aktivisht me çështjen:

Shtojca I

Neni 12 Përbërja e Dhomave

1. Dhomat përbëhen nga *gjashtëmbëdhjetë* gjykatës të përhershëm të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet dhe në çdo moment nga jo më shumë se nëntë gjykatës të pavarur *ad litem* të emëruar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 *ter*, të Statutit, çdo dy prej të cilëve nuk janë shtetas të një shteti.

2. Anëtarë të çdo Dhome Gjyqësore janë tre gjykatës të përhershëm dhe në çdo moment jo më shumë se gjashtë gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore në të cilën caktohen gjykatësit *ad litem* ndahet në trupa gjykues prej tre gjykatësish secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem*. Një trup gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

3. Anëtarë të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës të përhershëm. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet prej pesë prej anëtarëve të saj.

Neni 13 Kualifikimet e gjykatësve

1. Gjykatësit e përhershëm dhe *ad litem* duhet të jenë individë me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm që kanë kualifikimet e kërkuara në vendet e tyre përkatëse për t'u emëruar në postet më të larta juridike. Në përbërjen e përgjithshme të Dhomave dhe trupave gjykues, merret parasysh përvoja e gjykatësve në të drejtën penale dhe në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Neni 13 bis Zgjedhja e gjykatësve të përhershëm

1. Katërmëdhjetë prej gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme prej një liste të paraqitur nga Këshilli i Sigurimit, në këtë mënyrë:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara që të paraqesin kandidatura për gjykatës në Tribunalin Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditëve pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të propozojë më së shumti dy kandidatë që i plotësojnë kushtet e parashtruara në nenin 13 të Statutit, që nuk kanë të njëjtën shtetësi, dhe asnjëri prej të cilëve nuk do të ketë shtetësinë e ndonjë gjykatësi i cili është anëtar i Dhomës së Apelit dhe është zgjedhur ose emëruar gjykatës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe të Qytetarëve të Ruandës Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje prej 1 janarit 1994 deri më 31 dhjetor 1994 (më tej i quajtur "Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën") në përputhje me Nenin 12 bis të Statutit të atij Tribunali.
- (c) Emrat e propozuar, Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell Këshillit të Sigurimit. Prej propozimeve të marra, Këshilli i Sigurimit përpilon një listë me jo më pak se njëzetetë dhe jo më shumë se dyzetedy kandidatë, duke i kushtuar kujdes përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë.
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme zgjedh prej kësaj liste katërmëdhjetë gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar. Do të shpallen të zgjedhur kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se dy kandidatë me të njëjtën shtetësi marrin shumicën e nevojshme të votave, do të shpallet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

2. Po të mbetet ndonjë post i zbrazët në Dhoma ndërgjykatësit e përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me këtë nen, pas konsultimeve me Kryetarin e Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarin

e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm emëron për pjesën e mbetur të mandatit përkatës një person që përmbush kushtet sipas Nenit 13 të Statutit.

3. Gjykatësit e **përhershëm** të zgjedhur në përputhje me këtë nen zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Kushtet e shërbimit të tyre janë si ato të gjykatësve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

Neni 13 ter **Zgjedhja dhe emërimi i gjykatësve ad litem**

1. Gjykatësit *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen prej Asamblesë së Përgjithshme nga një listë e paraqitur prej Këshillit të Sigurimit në mënyrën e mëposhtme:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguese pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara, që të paraqesin kandidatura për gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditësh pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të caktojë deri në katër kandidatë që plotësojnë kualifikimet e përcaktuara në nenin 13 të Statutit, duke mbajtur parasyh një përfaqësim të drejtë të kandidatëve femra dhe meshkuj;
- (c) Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell emrat e propozuar Këshillit të Sigurimit. Prej emrave të propozuar Këshilli i Sigurimit përcakton një listë prej jo më pak se pesëdhjetekatër kandidatësh, duke i kushtuar vëmendjen e duhur përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë dhe duke mbajtur parasysh shpërndarjen e barabartë gjeografike;
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Prej kësaj liste Asambleja e Përgjithshme zgjedh njëzeteshtatë gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar. Kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguese pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara deklarohen të zgjedhur;
- (e) Gjykatësit *ad litem* deklarohen të zgjedhur për një mandat katërvjeçar. Ata nuk gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

2. Gjatë mandatit të tyre, gjykatësit *ad litem* emërohen prej Sekretarit të Përgjithshëm pas kërkesës së Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për të shërbyer në Dhoma Gjyqësore në një ose më shumë procese gjyqësore për një periudhë përmbledhëse deri në tri vjet, por jo saktësisht tri vjet. Në kërkesën për emërimin e një gjykatësi *ad litem*, Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar mban parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Statutit në lidhje me përbërjen e Dhomave dhe trupave gjyqësore të Dhomave Gjyqësore, përcaktimet e parashtuara në paragrafin 1 (b) dhe (c) më lart dhe numrin e votave që gjykatësi *ad litem* merr në Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 13 quater **Statusi i gjykatësve ad litem**

1. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit *mutadis mutandis* si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (b) varësisht prej paragrafit 2 të mëposhtëm gëzojnë të njëjtat kompetenca si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (c) gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit Ndërkombëtar;

2. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) nuk kanë të drejtë të zgjidhen ose të zgjedhin Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar apo Kryegjykatësin e një Dhoma Gjyqësore sipas nenit 14 të Statutit;
- (b) nuk kanë kompetencë:
 - (i) që të miratojnë rregullore procedurash dhe provash sipas nenit 15 të Statutit. Gjithsesi ata këshillohen para miratimit të këtyre rregulloreve;
 - (ii) që të shqyrtojnë një aktakuzë sipas nenit 19 të Statutit;

- (iii) që të këshillohen me Kryetarin në lidhje me caktimin e gjykatësve sipas nenit 14 të Statutit, ose në lidhje me një falje ose ndryshim të dënimit sipas nenit 28 të Statutit.
- (iv) që të marrin pjesë në procedurën paragjyqësore

Neni 14 **Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave**

1. Gjykatësit *e përhershëm* të Tribunalit Ndërkombëtar zgjedhin Kryetarin *nga radhët e veta*.
2. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar është anëtar i Dhomës së Apelit dhe kryeson punimet e saj.
3. Pas konsultimeve me gjykatësit *e përhershëm* të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomën e Apelit *katër gjykatës të përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 13 bis të Statutit dhe nëntë syresh në Dhomat Gjyqësore*.
4. *Dy gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 12 bis të Statutit të atij Tribunali caktohen nga Kryetari i atij Tribunali në konsultim me Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar, që të jenë anëtarë të Dhomës së Apelit dhe gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar.*
5. *Pas konsultimit me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomat Gjyqësore ata gjykatës ad litem që emërohen herë pas here për të shërbyer në Tribunalin Ndërkombëtar.*
6. Gjykatësi shërben vetëm në Dhomën ku ai ose ajo është caktuar.
7. Gjykatësit *e përhershëm* të secilës Dhomë Gjyqësore zgjedhin një Kryegjykatës *nga radhët e veta, i cili mbikëqyr në tërësi punën e Dhomës Gjyqësore.*

Shtojca II

Neni 11 Përbërja e Dhomave

Dhomat përbëhen prej *gjashtëmbëdhjetë* gjykatësish të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet, të cilët shërbejnë si vijon:

- (a) tre gjykatës shërbejnë në çdo Dhomë Gjyqësore ; dhe
- (b) *anëtarë të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet prej pesë prej anëtarëve të saj.*

Neni 12 Kualifikimet dhe zgjedhja e gjykatësve

1. Gjykatësit duhet të jenë individë me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm që kanë kualifikimet e kërkuara në vendet e tyre përkatëse për t'u emëruar në postet më të larta juridike. Në përbërjen e përgjithshme të Dhomave, merret parasysh përvoja e gjykatësve në të drejtën penale dhe në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

2. Njëmbëdhjetë prej gjykatësve të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme prej një liste të paraqitur nga Këshilli i Sigurimit, në këtë mënyrë:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara që të paraqesin kandidatura për gjykatës në Tribunalin Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditëve pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të propozojë më së shumti dy kandidatë që i plotësojnë kushtet e parashtruara në paragrafin e mësipërm 1, që nuk kanë të njëjtën shtetësi, dhe asnjëri prej të cilëve nuk do të ketë shtetësinë e ndonjë gjykatësi *i cili është anëtar i Dhomës së Apelit dhe është zgjedhur ose emëruar gjykatës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (më tej përmendet si "Tribunali Ndërkombëtar") në përputhje me Nenin 13 bis të Statutit të atij Tribunali.*
- (c) Emrat e propozuar, Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell Këshillit të Sigurimit. Prej propozimeve të marra, Këshilli i Sigurimit përpilon një listë me jo më pak se *njëzet* dhe jo më shumë se *tridhjetë* kandidatë, duke i kushtuar kujdes përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën.
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme zgjedh prej kësaj liste *njëmbëmbëdhjetë* gjykatës të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën. Do të shpallen të zgjedhur kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se dy kandidatë me të njëjtën shtetësi marrin shumicën e nevojshme të votave, do të shpallet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

3. Po të mbetet ndonjë post i zbrazët në Dhoma *ndër gjykatësit e zgjedhur ose të emëruar në përputhje me këtë nen*, pas konsultimeve me Kryetarin e Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm emëron për pjesën e mbetur të mandatit përkatës një person që përmbush kushtet e paragrafit të lartpërmendur 1.

4. Gjykatësit *e zgjedhur në përputhje me këtë nen* zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Kushtet e shërbimit të tyre janë si ato të gjykatësve të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ata gëzojnë të drejtën e rrizgjedhjes.

Neni 13 Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave

1. Gjykatësit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën zgjedhin një Kryetar.
2. *Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar është anëtar i një prej Dhomave Gjyqësore të këtij Tribunali.*

3. Pas konsultimeve me gjykatësit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, Kryetari cakton në *Dhomën e Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë* dy gjykatës të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me *Nenin 12 të Statutit* dhe *tetë syresh* në *Dhomat Gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën*. Gjykatësi shërben vetëm në *Dhomën* ku ai ose ajo është caktuar.

4. *Anëtarët e Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë shërbejnë edhe si anëtarë të Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën.*

5. Gjykatësit e çdo Dhome Gjyqësore zgjedhin një Kryegjykatës, i cili drejton në tërësi procedurat e asaj Dhome Gjyqësore.

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1411 (2002)
17 maj 2002

REZOLUTA 1411 (2002)

Miraturar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4535
më 17 maj 2002

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 955 (1994) të 8 nëntorit 1994, 1165 (1998) të 30 prillit 1998, 1166 (1998) të 13 majit 1998 dhe 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000,

Duke pranuar se personat të cilët janë propozuar ose janë zgjedhur ose emëruar si gjykatës të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ose Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën mund të kenë shtetësi të dy ose më shumë shteteve,

Duke qenë në dijeni se së paku një person i tillë tashmë është zgjedhur gjykatës i një prej Tribunalëve Ndërkombëtarë,

Duke marrë parasysh se në lidhje me anëtarësinë e Dhomave të Tribunalëve Ndërkombëtarë persona të tillë duhet të konsiderohen se kanë vetëm shtetësinë e shtetit ku ata zakonisht ushtrojnë të drejtat politike dhe qytetare,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos të ndryshojë nenin 12 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe ta zëvendësojë këtë nen me dispozitat e paraqitura në shtojcën I të kësaj rezolute;

2. Vendos gjithashtu të ndryshojë nenin 11 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe ta zëvendësojë këtë nen me dispozitat e paraqitura në shtojcën 2 të kësaj rezolute;

3. Vendos të mbetet aktivisht i angazhuar me çështjen.

SHTOJCA I

Neni 12 Përbërja e Dhomave

1. Dhomat përbëhen nga gjashtëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet dhe në çdo moment nga jo më shumë se nëntë gjykatës të pavarur *ad litem* të emëruar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 *ter* të Statutit, çdo dy prej të cilëve nuk janë shtetas të një shteti.

2. Anëtarë të çdo Dhome Gjyqësore janë tre gjykatës të përhershëm dhe në çdo moment jo më shumë se gjashtë gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore në të cilën caktohen gjykatësit *ad litem* ndahet në trupa gjykues prej tre gjykatësish, secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem*. Një trup gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

3. Anëtarë të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës të përhershëm. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet prej pesë prej anëtarëve të saj.

4. **Një individ i cili në kontekstin e anëtarësisë së Dhomave të Tribunalit Ndërkombëtar mund të konsiderohet si shtetas i më shumë se një shteti, do të gjykohet se është shtetas i shtetit në të cilin ai individ ushtron zakonisht të drejtat e tij politike dhe qytetare.**

SHTOJCA II

Neni 11 Përbërja e Dhomave

1. Dhomat përbëhen nga gjashtëmbëdhjetë gjykatës të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet, të cilët shërbejnë si vijon:

- (a) tre gjykatës shërbejnë në çdo Dhomë Gjyqësore ; dhe
- (b) anëtarë të Dhomes së Apelit janë shtatë gjykatës. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet prej pesë prej anëtarëve të saj.

2. Një individ i cili në kontekstin e anëtarësisë së Dhomave të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën mund të konsiderohet si shtetas i më shumë se një shteti, do të gjykohet se është shtetas i shtetit në të cilin ai individ ushtron zakonisht të drejtat e tij politike dhe qytetare.

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1431 (2002)
14 gusht 2002

REZOLUTA 1431 (2002)

Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4601
më 14 gusht 2002

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 955 (1994) të 8 nëntorit 1994, 1165 (1998) të 30 prillit 1998, 1166 (1998) të 13 majit 1998 dhe 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 955 (1994) të 8 nëntorit 1994, 1165 (1998) të 30 prillit 1998, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000 dhe 1411 (2002) të 17 majit 2002,

Pasi ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 14 shtator 2001 (S/2001/764) dhe letrën e bashkëngjitur të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën për Sekretarin e Përgjithshëm të datës 9 korrik 2001,

Pasi ka shqyrtuar gjithashtu letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 4 mars 2002 (S/2002/241) dhe letrën e bashkëngjitur të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën për Sekretarin e Përgjithshëm të datës 6 shkurt 2002,

I bindur për nevojën e krijimit të një grupi gjykatësish *ad litem* në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën për t'i mundësuar Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën që të përshpejtojë përfundimin e punës së vet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe i vendosur të ndjekë nga afër përparimin në funksionimin e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. *Vendos* të krijojë një grup gjykatësish *ad litem* në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën dhe për këtë qëllim *vendos* të ndryshojë nenet 11, 12 dhe 13 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe t'i zëvendësojë këto nene me dispozitat e paraqitura në shtojcën I të kësaj rezolute dhe *gjithashtu vendos* të ndryshojë nenet 13 *bis*, dhe 14 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe t'i zëvendësojë këto nene me dispozitat e paraqitura në shtojcën 2 të kësaj rezolute;

2. *Kërkon* që Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat praktike për zgjedhjet sa më të shpejta të tetëmbëdhjetë gjykatësve *ad litem* në përputhje me Nenin 12 *ter* të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe për vënien në dispozicion në kohë të burimeve njerëzore dhe materiale për Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën, në veçanti për gjykatësit *ad litem* dhe zyrat përkatëse të Prokurorit dhe *më tej kërkon* që ai ta mbajë vazhdimisht të informuar Këshillin e Sigurimit për përparimin në këtë aspekt;

3. *Nxit* të gjithë shtetet që të bashkëpunojnë plotësisht me Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën dhe organet e tyre në përputhje me detyrimet e tyre sipas rezolutës 955 (1994) dhe Statutin e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën;

4. *Vendos* të mbetet i angazhuar aktivisht me çështjen:

Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën

Shtojca I

Neni 11 Përbërja e Dhomave

1. Dhomat përbëhen nga gjashtëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet dhe në çdo moment nga jo më shumë se katër gjykatës të pavarur *ad litem* të emëruar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 12 *ter* të këtij Statuti, çdo dy prej të cilëve nuk janë shtetas të një shteti.

2. Anëtarë të çdo Dhome Gjyqësore janë tre gjykatës të përhershëm dhe në çdo moment jo më shumë se katër gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore në të cilën caktohen gjykatësit *ad litem* ndahet në trupa gjykues prej tre gjykatësish secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem*. Një trup gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

3. Anëtarë të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës të përhershëm. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet prej pesë prej anëtarëve të saj.

4. Një individ i cili në kontekstin e anëtarësisë së Dhomave të Tribunalit Ndërkombëtar mund të konsiderohet si shtetas i më shumë se një shteti, do të gjykohet se është shtetas i shtetit në të cilin ai individ ushtron zakonisht të drejtat e tij politike dhe qytetare.

Neni 12 Kualifikimet e gjykatësve

Gjykatësit e përhershëm dhe *ad litem* duhet të jenë individë me karakter të lartë moral, të paanshëm dhe të ndershëm që kanë kualifikimet e kërkuara në vendet e tyre përkatëse për t'u emëruar në postet më të larta juridike. Në përbërjen e përgjithshme të Dhomave dhe trupave gjykues, merret parasysh përvoja e gjykatësve në të drejtën penale dhe në të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Neni 12 bis Zgjedhja e gjykatësve të përhershëm

1. Njëmbëdhjetë prej gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme prej një liste të paraqitur nga Këshilli i Sigurimit, në këtë mënyrë:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionet vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara që të paraqesin kandidatura për gjykatës në Tribunalin Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditëve pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të propozojë më së shumti dy kandidatë që i plotësojnë kushtet e parashtruara në nenin 12 të Statutit, që nuk kanë të njëjtën shtetësi, dhe asnjëri prej të cilëve nuk do të ketë shtetësinë e ndonjë gjykatësi i cili është anëtar i Dhomës së Apelit dhe është zgjedhur ose emëruar gjykatës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (më tej i quajtur "Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë") në përputhje me nenin 13 *bis* të Statutit të atij Tribunali.
- (c) Emrat e propozuar, Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell Këshillit të Sigurimit. Prej propozimeve të marra, Këshilli i Sigurimit përpilon një listë me jo më pak se njëzetedy dhe jo më shumë se tridhjetetë kandidatë, duke i kushtuar kujdes përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën.

- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme zgjedh prej kësaj liste njëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën. Do të shpallen të zgjedhur kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionë vëzhguesë të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se dy kandidatë me të njëjtën shtetësi marrin shumicën e nevojshme të votave, do të shpallet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

2. Po të mbetet ndonjë post i zbrazët në Dhoma ndër gjykatësit e përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me këtë nen, pas konsultimeve me Kryetarin e Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm emëron për pjesën e mbetur të mandatit përkatës një person që përmbush kushtet sipas nenit 12 të këtij Statuti.

3. Gjykatësit e përhershëm të zgjedhur në përputhje me këtë nen zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Kushtet e shërbimit të tyre janë si ato të gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

Neni 12 ter **Zgjedhja dhe emërimi i gjykatësve *ad litem***

1. Gjykatësit *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën zgjidhen prej Asamblesë së Përgjithshme nga një listë e paraqitur prej Këshillit të Sigurimit në mënyrën e mëposhtme:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguesë pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara, që të paraqesin kandidatura për gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditësh pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të caktojë deri në katër kandidatë që plotësojnë kualifikimet e përcaktuara në nenin 12 të këtij Statuti, duke mbajtur parasyh një përfaqësim të drejtë të kandidatëve femra dhe meshkuj;
- (c) Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell emrat e propozuar Këshillit të Sigurimit. Prej emrave të propozuar Këshilli i Sigurimit përcakton një listë prej jo më pak se tridhjetëgjatë kandidatësh, duke i kushtuar vëmendjen e duhur përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë dhe duke mbajtur parasysh shpërndarjen e barabartë gjeografike;
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Prej kësaj liste Asambleja e Përgjithshme zgjedh tetëmbëdhjetë gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën. Kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguesë pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara deklarohen të zgjedhur;
- (e) Gjykatësit *ad litem* deklarohen të zgjedhur për një mandat katërvjeçar. Ata nuk gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

2. Gjatë mandatit të tyre, gjykatësit *ad litem* emërohen prej Sekretarit të Përgjithshëm pas kërkesës së Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën për të shërbyer në Dhoma Gjyqësore në një ose më shumë procese gjyqësore për një periudhë përmbledhëse deri në tri vjet, por jo saktësisht tri vjet. Në kërkesën për emërimin e një gjykatësi *ad litem*, Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar mban parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij Statuti në lidhje me përbërjen e Dhomave dhe trupave gjyqësore të Dhomave Gjyqësore, përcaktimet e parashtruara në paragrafin 1 (b) dhe (c) më lart dhe numrin e votave që gjykatësi *ad litem* merr në Asambleshën e Përgjithshme.

Neni 12 quater
Statusi i gjykatësve *ad litem*

1. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën, gjykatësit *ad litem*:
 - (a) Përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit mutadis mutandis si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën;
 - (b) Varësisht prej paragrafit 2 të mëposhtëm gëzojnë të njëjtat kompetenca si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën;
 - (c) Gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën;

2. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën, gjykatësit *ad litem*:
 - (a) Nuk kanë të drejtë të zgjidhen ose të zgjedhin Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën ose Kryegjykatësin e një Dhome Gjyqësore sipas nenit 13 të këtij Statuti;
 - (b) Nuk kanë kompetencë:
 - (i) që të miratojnë rregullore procedurash dhe provash sipas nenit 14 të këtij Statuti. Gjithsesi ata këshillohen para miratimit të këtyre rregulloreve;
 - (ii) që të shqyrtojnë një aktakuzë sipas nenit 18 të këtij Statuti;
 - (iii) që të këshillohen me Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën në lidhje me caktimin e gjykatësve sipas nenit 13 të këtij Statuti, ose në lidhje me një falje ose ndryshim të dënimit sipas nenit 27 të këtij Statuti;
 - (iv) që të marrin pjesë në procedurën parajyqësore.

Neni 13
Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave

1. Gjykatësit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën zgjedhin një Kryetar nga radhët e veta.
2. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar është anëtar i një prej Dhomave Gjyqësore të këtij Tribunali.
3. Pas konsultimeve me gjykatësit e Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, Kryetari cakton në Dhomën e Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dy gjykatës të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 12 të Statutit dhe tetë syresh në Dhomat Gjyqësore të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën.
4. Anëtarët e Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë shërbejnë edhe si anëtarë të Dhomës së Apelit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën.
5. Pas konsultimit me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, Kryetari cakton në Dhomat Gjyqësore ata gjykatës *ad litem* që emërohen herë pas here për të shërbyer në Tribunalin Ndërkombëtar për Ruandën.
6. Gjykatësi shërben vetëm në Dhomën ku ai ose ajo është caktuar.
7. Gjykatësit e përhershëm të secilës Dhomë Gjyqësore zgjedhin një Kryegjykatës nga radhët e veta, i cili mbikëqyr në tërësi punën e Dhomës Gjyqësore.

Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë

Shtojca II

Neni 13 bis

Zgjedhja e gjykatësve të përhershëm

1. Katërbëdhjetë prej gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme prej një liste të paraqitur nga Këshilli i Sigurimit, në këtë mënyrë:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misione vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara që të paraqesin kandidatura për gjykatës në Tribunalin Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditëve pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të propozojë më së shumti dy kandidatë që i plotësojnë kushtet e parashtruara në nenin 13 të Statutit, që nuk kanë të njëjtën shtetësi, dhe asnjëri prej të cilëve nuk do të ketë shtetësinë e ndonjë gjykatësi i cili është anëtar i Dhomës së Apelit dhe është zgjedhur ose emëruar gjykatës i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ruandës dhe të Qytetarëve të Ruandës Përgjegjës për Gjenocid dhe Shkelje të Tjera të Rënda të Kryera në Territorin e Shteteve Fqinje prej 1 janarit 1994 deri më 31 dhjetor 1994 (më tej i quajtur “Tribunali Ndërkombëtar për Ruandën”) në përputhje me Nenin 12 bis të Statutit të atij Tribunali;
- (c) Emrat e propozuar, Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell Këshillit të Sigurimit. Prej propozimeve të marra, Këshilli i Sigurimit përpilon një listë me jo më pak se njëzetetë dhe jo më shumë se dyzetedy kandidatë, duke i kushtuar kujdes përfaqësimit të duhur të sistemeve kryesore juridike në botë.
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme zgjedh prej kësaj liste katërbëdhjetë gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar. Do të shpallen të zgjedhur kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misione vëzhguese të përhershme në selinë e Kombeve të Bashkuara. Në qoftë se dy kandidatë me të njëjtën shtetësi marrin shumicën e nevojshme të votave, do të shpallet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

2. Po të mbetet ndonjë post i zbrazët në Dhoma ndër gjykatësit e përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me këtë nen, pas konsultimeve me Kryetarin e Këshillit të Sigurimit dhe Kryetarin e Asamblesë së Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm emëron për pjesën e mbetur të mandatit përkatës një person që përmbush kushtet sipas Nenit 13 të Statutit.

3. Gjykatësit e përhershëm të zgjedhur në përputhje me këtë nen zgjidhen për një mandat katërvjeçar. Kushtet e shërbimit të tyre janë si ato të gjykatësve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.

Neni 14

Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave

1. Gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar zgjedhin Kryetarin nga radhët e veta.
2. Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar është anëtar i Dhomës së Apelit dhe kryeson punimet e saj.
3. Pas konsultimeve me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomën e Apelit katër gjykatës të përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 13 bis të Statutit dhe nëntë syresh në Dhomat Gjyqësore.
4. Dy gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 12 bis të Statutit të atij Tribunali caktohen nga Kryetari i atij Tribunali, në konsultim me Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar, që të jenë anëtarë të Dhomës së Apelit dhe gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar.
5. Pas konsultimit me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomat Gjyqësore ata gjykatës *ad litem* që emërohen herë pas here për të shërbyer në Tribunalin Ndërkombëtar.
6. Gjykatësi shërben vetëm në Dhomën ku ai ose ajo është caktuar.

7. Gjykatësit e përhershëm të secilës Dhomë Gjyqësore zgjedhin një Kryegjykatës nga radhët e veta, i cili mbikëqyr në tërësi punën e Dhomës Gjyqësore.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1481 (2003)
19 maj 2003

REZOLUTA 1481 (2003)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4759
më 19 maj 2003**

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002 dhe 1431 (2002) të 14 gushtit 2002,

Pasi ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 18 mars 2002 (S/2002/304) dhe letrën e bashkëngjitur të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për Sekretarin e Përgjithshëm të datës 12 mars 2002,

Pasi ka shqyrtuar gjithashtu letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 7 maj 2003 (S/2002/530) dhe letrën e bashkëngjitur të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën për Sekretarin e Përgjithshëm të datës 1 maj 2003,

I bindur për dobinë e zgjerimit të kompetencave të gjykatësve ad litem në Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në mënyrë që gjatë periudhës së detyrës së tyre në një proces gjyqësor, ata të mund të procedojnë në fazën parajyqësore në mënyrë të tjerë, në rast nevojë dhe nëqoftëse është e mundur në mënyrë të përshtatshme.

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendosi të ndryshojë nën 13 *quater* të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe ta zëvendësojë këtë nën me dispozitat e paraqitura në shtojcën e kësaj rezolute;

2. Vendosi të mbetet i angazhuar aktivisht me çështjen:

Shtojcë
Neni 13 quater

Statusi i gjykatësve *ad litem*

1. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) Përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit *mutadis mutandis* si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (b) Varësisht prej paragrafit 2 rë mëposhtëm gëzojnë të njëjtat kompetenca si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (c) Gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (d) Gëzojnë **kompetencë të procedojnë në procedura paragjyqësore në çështje të tjera veç atyre që janë emëruar për të gjykuar.**

2. Gjatë periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) nuk kanë të drejtë të zgjidhen ose të zgjedhin Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar apo Kryegjykatësin e një Dhoma Gjyqësore sipas nenit 14 të Statutit;
- (b) nuk kanë kompetencë:
 - (i) që të miratojnë rregullore procedurash dhe provash sipas nenit 15 të Statutit. Gjithsesi ata këshillohen para miratimit të këtyre rregulloreve;
 - (ii) që të shqyrtojnë një aktakuzë sipas nenit 19 të Statutit;
 - (iii) që të këshillohen me Kryetarin në lidhje me caktimin e gjykatësve sipas nenit 14 të Statutit, ose në lidhje me një falje ose ndryshim të dënimit sipas nenit 28 të Statutit.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1597 (2005)
20 prill 2005

REZOLUTA 1597 (2005)

**Miraturar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5165,
më 20 prill 2005**

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta, 827 (1993) të 25 majit 1993, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002, 1431 (2002) të 14 gushtit 2002, 1481 (2003) të 19 majit 2003, 1503 (2003) të 28 gushtit 2003 dhe 1534 (2004) të 26 marsit 2004,

*Pasi ka shqyrtuar letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 24 shkurt 2005 (S/2005/127) ku bëhet e ditur lista e kandidatëve për t'u zgjedhur si gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,*

Duke marrë shënim se Sekretari i Përgjithshëm sugjeroi që afati për caktimin e emrave të shtyhej deri më 31 mars 2005 dhe përgjigjen e Kryetarit më 14 mars 2005 (S/2005/159) ku bëhej e ditur se Këshilli i Sigurimit kishte miraturar zgjatjen e afatit,

*Pasi ka shqyrtuar gjithashtu letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 11 prill 2005 (S/2005/236) ku sugjerohej zgjatja e mëtejshme e afatit për caktimin e emrave të kandidatëve për t'u zgjedhur si gjykatës *ad litem*,*

Duke marrë shënim se numri i kandidatëve nuk plotëson numrin minimal për zgjedhje përcaktuar prej Statutit të Tribunalit,

*Duke marrë parasysh se 27 gjykatësit *ad litem* të zgjedhur prej Asamblesë së Përgjithshme në mbledhjen e saj plenare të 102-të më 12 qershor 2001, mandati i të cilëve përfundon më 11 qershor 2005, duhet të kenë të drejtën e rizgjedhjes, dhe duke dashur të ndryshojë Statutin për këtë qëllim,*

*Duke marrë shënim se nëqoftëse periudha e gjithsejtë e shërbimit të një gjykatësi *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë është tri vjet ose më shumë, kjo nuk do të rezultojë në ndonjë ndryshim në privilegjet dhe përfitimet e tyre dhe në veçanti nuk do të rezultojë në privilegje dhe përfitime shtesë përveç atyre ekzistuese dhe të cilat në një rast të tilë do të vazhdojnë më tej në përpjestim me zgjatjen e periudhës së shërbimit.*

Bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos të ndryshojë nenin 13 *ter* të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe ta zëvendësojë këtë nen me dispozitën e paraqitur në shtojcën e kësaj rezolute;

2. Gjithashtu vendos që në lidhje me letrën e Sekretarit të Përgjithshëm të 11 priillit 2005 (S/2005/236) të zgjasë afatin për caktimin e emrave për gjykatës *ad litem* sipas dispozitës së ndryshuar të Statutit me 30 ditë më shumë nga data e miratimit të kësaj rezolute;

3. Vendos që të mbetet aktivisht i angazhuar me këtë çështje;

Shtojcë

Neni 13 ter

Zgjedhja dhe emërimi i gjykatësve *ad litem*

1. Gjykatësit *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar zgjidhen prej Asamblesë së Përgjithshme nga një listë e paraqitur prej Këshillit të Sigurimit në mënyrën e mëposhtme:

- (a) Sekretari i Përgjithshëm fton shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shtetet joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguese pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara, që të paraqesin emra për gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar.
- (b) Brenda gjashtëdhjetë ditësh pas ftesës së Sekretarit të Përgjithshëm, çdo shtet mund të caktojë deri në katër kandidatë që plotësojnë kualifikimet e përcaktuara në nenin 13 të Statutit, duke mbajtur parasyh një përfaqësim të drejtë të kandidatëve femra dhe meshkuj;
- (c) Sekretari i Përgjithshëm ia përcjell emrat e propozuar Këshillit të Sigurimit. Prej emrave të propozuar Këshilli i Sigurimit përcakton një listë me jo më pak se pesëdhjetekatër kandidatë, duke i kushtuar vëmendjen e duhur përfaqësimit të mjaftueshëm të sistemeve kryesore juridike në botë dhe duke mbajtur parasysh shpërndarjen e barabartë gjeografike;
- (d) Kryetari i Këshillit të Sigurimit ia përcjell listën e kandidatëve Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme. Prej kësaj liste Asambleja e Përgjithshme zgjedh njëzeteshtatë gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar. Kandidatët që marrin shumicën absolute të votave të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të shteteve joanëtare që kanë misionë të përhershme vëzhguese pranë Selisë së Kombeve të Bashkuara deklarohen të zgjedhur;
- (e) Gjykatësit *ad litem* deklarohen të zgjedhur për një mandat katërvjeçar. **Ata gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.**

2. Gjatë **çfarëdo** mandati, gjykatësit *ad litem* emërohen prej Sekretarit të Përgjithshëm pas kërkesës së Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për të shërbyer në Dhoma Gjyqësore në një ose më shumë procese gjyqësore për një periudhë përmbledhëse deri në tri vjet, por jo saktësisht tri vjet. Në kërkesën për emërimin e një gjykatësi *ad litem*, Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar mban parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 13 të Statutit në lidhje me përbërjen e Dhomave dhe trupave gjyqësore të Dhomave Gjyqësore, përcaktimet e parashtuara në paragrafin 1 (b) dhe (c) më lart dhe numrin e votave që gjykatësi *ad litem* merr në Asamblenë e Përgjithshme.

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje.
E PËRGJITHSHME

S/RES/1660 (2006)
28 shkurt 2006

REZOLUTA 1660 (2006)

**Miraturar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5382,
më 28 shkurt 2006**

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta, 827 (1993) të 25 majit 1993, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002, 1431 (2002) të 14 gushtit 2002, 1481 (2003) të 19 majit 2003, 1503 (2003) të 28 gushtit 2003, 1534 (2004) të 26 marsit 2004 dhe 1597 (2005) të 20 prillit 2005,

Pasi ka shqyrtuar propozimin e Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë që Sekretari i Përgjithshëm me kërkesë të Kryetarit të emërojë gjykatës rezervë nga gjykatësit *ad litem* të zgjedhur në përputhje me Nenin 13 ter, që të jenë të pranishëm në çdo fazë të procesit gjyqësor në të cilin janë caktuar dhe për zëvendësimin e një gjykatësi nëqoftëse ai gjykatës nuk është në gjendje të marrë pjesë në seanca,

I bindur për dobinë e mundësisë që Sekretari i Përgjithshëm të emërojë gjykatës rezervë për procese të caktuara në Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë kur kërkohet prej Kryetarit të Tribunalit.

Bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos të ndryshojë nenin 12 dhe nenin 13 *quater* të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe t'i zëvendësojë këto nene me dispozitat e paraqitur në shtojcën e kësaj rezolute;

2. Vendos që të mbetet i angazhuar me këtë çështje;

Shtojcë

Neni 12 Përbërja e Dhomave

1. *Dhomat* përbëhen nga gjashtëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet dhe në çdo moment nga jo më shumë se dymbëdhjetë gjykatës të pavarur *ad litem* të emëruar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 *ter*, të Statutit, çdo dy prej të cilëve nuk janë shtetas të një shteti.

2. *Anëtarë* të çdo Dhome Gjyqësore janë tre gjykatës të përhershëm dhe në çdo moment jo më shumë se nëntë gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore në të cilën caktohen gjykatësit *ad litem* ndahet në trupa gjykues prej tre gjykatësish secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem* përveç rrethanave të përcaktuara në paragrafin 5 më poshtë. Një trup gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

3. *Anëtarë* të Dhomës së Apelit janë shtatë gjykatës të përhershëm. Në çdo apelim, Dhoma e Apelit përbëhet prej pesë prej anëtarëve të saj.

4. Një individ i cili në kontekstin e anëtarësisë së Dhomave të Tribunalit Ndërkombëtar mund të konsiderohet si shtetas i më shumë se një shteti, do të gjykohet se është shtetas i shtetit në të cilin ai individ ushtron zakonisht të drejtat e tij politike dhe qytetare.

5. Me kërkesë të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar, Sekretari i Përgjithshëm emëron nga gjykatësit *ad litem* të zgjedhur në përputhje me Nenin 13 *ter*, gjykatës rezervë për të qenë të pranishëm në çdo fazë të një procesi gjyqësor ku ata janë emëruar dhe për zëvendësimin e një gjykatësi nëqoftëse ky gjykatës nuk është në gjendje të marrë pjesë.

6. Pa *paragjykuar* paragrafin e mësipërm 2, në rast se rrethana të veçanta kërkojnë zëvendësimin e një gjykatësi të përhershëm të një trupi gjykues duke rezultuar në një trup gjykues të përbërë vetëm prej gjykatësve *ad litem*, ky trup gjykues mund të vazhdojë me çështjen gjyqësore, pavarësisht se nuk ka asnjë gjykatës të përhershëm në përbërje.

Neni 13 *quater* Statusi i gjykatësve *ad litem*

1. *Gjatë* periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) Përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit mutadis mutandis si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (b) Varësisht prej paragrafit 2 rë mëposhtëm gëzojnë të njëjtat kompetenca si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (c) Gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (d) Gëzojnë kompetencë të procedojnë në procedura paragjyqësore në çështje të tjera veç atyre që janë emëruar për të gjykuar.

2. *Gjatë* periudhës së emërimit të tyre në Tribunalin Ndërkombëtar, gjykatësit *ad litem*:

- (a) Nuk kanë të drejtë të zgjidhen ose të zgjedhin Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar apo Kryegjykatësin e një Dhome Gjyqësore sipas nenit 14 të Statutit;
- (b) Nuk kanë kompetencë:
 - (i) që të miratojnë rregullore procedurash dhe provash sipas nenit 15 të Statutit. Gjithsesi ata këshillohen para miratimit të këtyre rregulloreve;
 - (ii) që të shqyrtojnë një aktakuzë sipas nenit 19 të Statutit;
 - (iii) që të këshillohen me Kryetarin në lidhje me caktimin e gjykatësve sipas nenit 14 të Statutit, ose në lidhje me një falje ose ulje të dënimit sipas nenit 28 të Statutit.

3. Pavarësisht paragrafëve të mësipërm 1 dhe 2, gjykatësit *ad litem* që shërbejnë si gjykatës rezervë:

- (a) Përfitojnë prej kushteve dhe rregullave të njëjta të shërbimit *mutadis mutandis* si gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar;
- (b) Gëzojnë privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet prej detyrimeve dhe lehtësirat e një gjykatësi të Tribunalit ndërkombëtar;
- (c) Gëzojnë kompetencë të procedojnë në procedura paragjyqësore në çështje të tjera veç atyre që janë emëruar për të gjykuar dhe për këtë qëllim e varësisht prej paragrafit të mësipërm 2, gëzojnë të njëjtat kompetenca si gjykatësit e përhershëm

4. Në rast se një gjykatës rezervë zëvendëson një gjykatës që nuk mund të vazhdojë të marrë pjesë, në atë periudhë ai ose ajo do të përfitojë prej dispozitave të paragarit të mësipërm 1.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje.
E PËRGJITHSHME

S/RES/1837 (2008)
29 shtator 2008

REZOLUTA 1837 (2008)

**Miraturar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5986,
më 29 shtator 2008**

Këshilli i Sigurimit,

Duke marrë shënim letrën e Sekretarit të Përgjithshëm me datë 24 shtator 2008, adresuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit, së cilës i janë bashkëlidhur dy letra për të prej Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("Tribunali") me data 5 qershor 2008 dhe 1 shtator 2008 (S/2008/621).

Duke rikujtuar rezolutat e veta, 1581 (2005) të 18 janarit 2005, 1597 (2005) të 20 prillit 2005, 1613 (2005) të 26 korrikut 2005, 1629 (2005) të 30 shtatorit 2005, 1660 (2006) të 28 shkurtit 2006, 1668 (2006) të 10 prillit 2006, dhe 1800 (2008) të 20 shkurtit 2008.

Duke rikujtuar në veçanti rezolutat e veta 1503 (2003) të 28 gushtit 2003 dhe 1534 (2004) të 26 marsit 2004 në të cilat Këshilli i Sigurimit i bën thirrje Tribunalit që të marrë të gjitha masat e mundshme për përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, përfundimin e të tëra gjykimeve të shkallës së parë brenda vitit 2008, dhe përfundimin e krejt punës në vitin 2010.

Duke shprehur vendosmërinë e vet për mbështetjen e përpjekjeve të Tribunalit në përfundimin e proceseve gjyqësore në datën më të hershme,

Duke shprehur bindjen se zgjatja e mandatit të gjykatësve përkatës do të shtojë efektivitetin e proceseve gjyqësore dhe do të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë Përmbyllëse,

Bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. Vendos të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve të përhershëm të mëposhtëm të Tribunalit, të cilët janë anëtarë të Dhomës së Apelit, deri më 31 dhjetor 2010, ose deri në përfundimin e çështjeve në Dhomën e Apelit nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Liu Daqun (Kinë)
- Theodor Meron (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)
- Fausto Pocar (Itali)
- Mohamed Shahabuddeen (Gujanë)

2. Vendos të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve të përhershëm të mëposhtëm të Tribunalit, të cilët janë anëtarë të Dhomave Gjyqësore, deri më 31 dhjetor 2009, ose deri në përfundimin e çështjeve për të cilat janë aktuar nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Carmel Agius (Maltë)
- Jean-Claude Antonetti (Francë)
- Iain Bonomy (Britani e Madhe)
- Christoph Flügge (Guajanë)
- O-Gon Kwon (Kore e Jugut)
- Bakone Justice Moloto (Afrikë e Jugut)

- Alfons Orie (Holandë)
- Kevin Parker (Australi)
- Patrick Robinson (Xhamaikë)
- Christine Van den Wyngaert (Belgjikë)

3. Vendos të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve *ad litem* të mëposhtëm, të cilët aktualisht shërbejnë në Tribunal, deri më 31 dhjetor 2009, ose deri në përfundimin e çështjeve për të cilat janë caktuar nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Ali Nawaz Chowhan (Pakistan)
- Pedro David (Argjentinë)
- Elizabeth Gwaunza (Zimbabve)
- Frederik Harhoff (Danimarkë)
- Tsvetana Kamenova (Bullgari)
- Uldis Kinis (Letoni)
- Flavia Lattanzi (Itali)
- Antoine Kesia-Mbe Mindua (Republika Demokratike e Kongos)
- Janet Nosworthy (Xhamaikë)
- Michèle Picard (Francë)
- Árpád Prandler (Hungari)
- Kimberly Prost (Kanada)
- Ole Bjørn Støle (Norvegji)
- Stefan Trechsel (Zvicër)

4. Vendos të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve *ad litem* të mëposhtëm, të cilët aktualisht nuk janë emëruar për të shërbyer në Tribunal, deri më 31 dhjetor 2009, ose deri në përfundimin e atyre çështjeve për të cilat mund të caktohen nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Melville Baird (Trinidad dhe Tobako)
- Frans Bauduin (Holandë)
- Burton Hall (Bahama)
- Frank Høpfel (Austri)
- Raimo Lahti (Finlandë)
- Jawdat Naboty (Republika Arabe e Sirisw)
- Chioma Egondy Nwosu-Iheme (Nigeri)
- Prisca Matimba Nyambe (Zambia)
- Brynmor Pollard (Guajanë)
- Vonimbolana Rasoazanany (Madagaskar)
- Krister Thelin (Suedi)
- Klaus Tolksdorf (Gjermani)
- Tan Sri Dato Lamin Haji Mohd Yunus (Malajzi)

5. Vendos pa paragjykuar dispozitat e rezolutës 1800 (2008) të 20 shkurtit 2008, të ndryshojë paragrafët 1 dhe 2 të nenit 12 të Statutit të Tribunalit dhe t'i zëvendësojë këta paragrafë me dispozitat e paraqitura në shtojcën e kësaj rezolute.

6. Vendos që të mbetet i angazhuar me këtë çështje.

Shtojcë

Neni 12 Përbërja e Dhomave

1. Dhomat përbëhen nga jo më shumë se gjashtëmbëdhjetë gjykatës të përhershëm të pavarur, çdo dy prej të cilëve nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet dhe në çdo moment nga jo më shumë se dymbëdhjetë gjykatës të pavarur *ad litem* të emëruar në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 *ter* të Statutit, çdo dy prej të cilëve nuk janë shtetas të një shteti.

2. Anëtarë të çdo Dhome Gjyqësore janë në çdo moment jo më shumë se tre gjykatës të përhershëm dhe gjashtë gjykatës *ad litem*. Çdo Dhomë Gjyqësore në të cilën caktohen gjykatësit *ad litem* ndahet në trupa gjykues prej tre gjykatësish, secili me gjykatës të përhershëm dhe *ad litem* përveç rrethanave të përcaktuara në paragrafin 5 më poshtë. Një trup gjykues i një Dhome Gjyqësore ka të njëjtat kompetenca dhe përgjegjësi si Dhoma Gjyqësore sipas Statutit dhe shqipton aktgjykime në përputhje me të njëjtat rregulla.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje.
E PËRGJITHSHME

S/RES/1877 (2009)
7 korrik 2009

REZOLUTA 1877 (2009)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 6155,
më 7 korrik 2009**

Këshilli i Sigurimit,

Duke marrë shënim letrën e Sekretarit të Përgjithshëm me datë 19 qershor 2009, adresuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit, së cilës i janë bashkëngjitur letra prej Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Tribunali Ndërkombëtar”) me datë 27 maj 2009 dhe letra prej Kryetarit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (“TPNR”) me datë 29 maj 2009. (S/2009/333).

Duke rikujtuar rezolutat e veta, 827 (1993) të 25 majit 1993, 1581 (2005) të 18 janarit 2005, 1597 (2005) të 20 prillit 2005, 1613 (2005) të 26 korrikut 2005, 1629 (2005) të 30 shtatorit 2005, 1660 (2006) të 28 shkurtit 2006, 1668 (2006) të 10 prillit 2006, 1800 (2008) të 20 shkurtit 2008, 1837 (2008) të 29 shtatorit 2008 dhe 1849 (2008) të 12 dhjetorit 2008,

Duke rikujtuar në veçanti rezolutat e veta 1503 (2003) të 28 gushtit 2003 dhe 1534 (2004) të 26 marsit 2004 në të cilat Këshilli i Sigurimit i bën thirrje Tribunalit Ndërkombëtar që të marrë të gjitha masat e mundshme për përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, përfundimin e të tëra gjykimeve të shkallës së parë brenda vitit 2008, dhe përfundimin e krejt punës në vitin 2010,

Duke marrë shënim vlerësimin e Tribunalit Ndërkombëtar në Raportin mbi Strategjinë e vet Përmblyëse (S/2009/252) se Tribunali nuk do të jetë në gjendje të përfundojë krejtësisht punën në 2010,

Duke marrë parasysh propozimet e paraqitura nga Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar,

Duke shprehur vendosmërinë e vet për mbështetjen e përpjekjeve të Tribunalit Ndërkombëtar në përfundimin e proceseve gjyqësore në datën më të hershme,

Duke rikujtuar se në rezolutën e vet 1837 (2008), Këshilli i Sigurimit zgjati kohën e shërbimit të gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, ndër të cilët gjykatësit e përhershëm Liu Daqun (Kinë), Theodor Meron (Shtetet e Bashkuara të Amerikës), dhe Fausto Pocar (Itali), të cilët janë anëtarë të Dhomës së Apelit, deri më 31 dhjetor 2010, ose deri në përfundimin e çështjeve për të cilat janë caktuar nëse mbarojnë në një datë më të hershme,

Duke shprehur bindjen se zgjatja e kohës së shërbimit të gjykatësve do të shtojë efektivitetin e proceseve gjyqësore dhe do të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë Përmblyëse të Tribunalit Ndërkombëtar,

Duke marrë shënim, se gjykatësit e përhershëm Iain Bonomy (Britani e Madhe), Mohamed Shahabuddeen (Guajanë) dhe Christine Van den Vyngaert (Belgjikë) kanë dhënë dorëheqjen prej Tribunalit Ndërkombëtar,

I bindur për dobinë e lejimit të Sekretarit të Përgjithshëm që të emërojë një gjykatës *ad litem* shtesë veç 12 gjykatësve *ad litem* të autorizuar prej Statutit, si masë e përkohshme, për t'i mundësuar Tribunalit Ndërkombëtar që të caktojë një gjykatës rezervë në një prej proceseve gjyqësore, dhe *duke*

marrë shënim sigurimet e Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar se kjo masë e përkohshme do të jetë brenda burimeve ekzistuese,

I bindur gjithashtu për nevojën e zgjerimit të anëtarësisë së Dhomës së Apelit bazuar në shtimin e pritshëm të ngarkesës së punës për Dhomën e Apelit pas përfundimit të proceseve gjyqësore,

Duke theksuar nevojën e garancisë që asnjë prej gjykatësve të Dhomës së Apelit të mos caktohet për një çështje për të cilën ai ose ajo është caktuar në fazën paragjyqësore,

Duke nxitur Tribunalin Ndërkombëtar që të marrë të gjitha masat e mundshme për përfundimin e punës së tij sa më shpejt,

Bazuar në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. *Vendos* të rishikojë zgjatjen e kohës së shërbimit të gjykatësve të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar të cilët janë anëtarë të Dhomës së Apelit, deri më 31 dhjetor 2009, bazuar në ecurinë e zbatimit të Strategjisë Përmbyllëse prej Tribunalit Ndërkombëtar;

2. *Vendos* të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve të përhershëm të mëposhtëm të Tribunalit, deri më 31 dhjetor 2010, ose deri në përfundimin e çështjeve për të cilat janë caktuar nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Carmel Agius (Maltë)
- Jean-Claude Antonetti (Francë)
- Christoph Flügge (Guajanë)
- O-Gon Kwon (Kore e Jugut)
- Bakone Justie Moloto (Afrikë e Jugut)
- Alfons Orië (Holandë)
- Kevin Parker (Australi)
- Patrick Robinson (Xhamaikë)

3. *Vendos* që koha e shërbimit e gjykatësve të përhershëm të emërua në vend të Ian Bonomy (Britani e Madhe), Mohamed Shahabuddeen (Guajana) dhe Christine Van den Eyngaert (Belgjikë) të zgjatet deri më 31 dhjetor 2010, ose deri në përfundimin e çështjeve për të cilat do të caktohen nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Ali Naëaz Choëhan (Pakistan)
- Tsvetana Kamenova (Bullgari)

4. *Vendos* të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve *ad litem* të mëposhtëm, të cilët aktualisht shërbejnë në Tribunal, deri më 31 dhjetor 2009, ose deri në përfundimin e atyre çështjeve për të cilat caktohen nëse mbarojnë në një datë më të hershme:

- Melville Baird (Trinidad dhe Tobako)
- Pedro David (Argjentinë)
- Elizabeth Gwaunza (Zimbabve)
- Frederik Harhoff (Danimarkë)
- Uldis Kinis (Letoni)
- Flavia Lattanzi (Itali)
- Antoine Kesia-Mbe Mindua (Republika Demokratike e Kongos)
- Michèle Picard (Francë)
- Àrpád Prandler (Hungari)
- Stefan Trechsel (Zvicër)

5. *Vendos* të zgjasë kohën e shërbimit të gjykatësve *ad litem* të mëposhtëm, të cilët aktualisht nuk shërbejnë në Tribunal, deri më 31 dhjetor 2009, ose deri në përfundimin e atyre çështjeve për të cilat mund të caktohen nëse mbarojnë në një datë më të hershme

- Frans Bauduin (Holandë)
- Burton Hall (Bahama)
- Raimo Lahti (Finlandë)
- Jawdat Naboty (Republika Arabe e Sirisë)
- Chioma Egongdu Nwosu-Iheme (Nigeri)
- Prisca Matimba Nyambe (Zambia)
- Vonimbolana Rasoazanany (Madagaskar)
- Tan Sri Dato Lamin Haji Mohd Yunus (Malajzi)

6. *Vendos* të lejojë gjykatësit *ad litem*, Harhoff, Lattanzi, Mindua, Prandler dhe Trechsel që të shërbejnë në Tribunalin Ndërkombëtar përtej periudhës përmvledhëse të shërbimit përcaktuar në paragrafin 2, të nenit 13 të Statutit të Tribunalit ndërkombëtar;

7. *Vendos* që me kërkesë të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar, Sekretari i Përgjithshëm të emërojë gjykatës shtesë *ad litem* për të përfunduar proceset gjyqësore ekzistuese ose për kryerjen e procese gjyqësore shtesë, pavarësisht faktit se numri i gjithsejtë i gjykatësve *ad litem* në Tribunalin Ndërkombëtar herë pas herë do të tejkalojë përkohësisht kufirin e sipërm prej dymbëdhjetë gjykatësish përcaktuar prej paragrafit 1 të nenit 12 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar, duke shkuar në një maksimum prej 13 gjykatësish në çfarëdo kohe, dhe duke u kthyer në maksimumin prej dymbëdhjetë brenda 31 dhjetorit 2009;

8. *Vendos* të ndryshojë paragrafin 3 të nenit 14 dhe paragrafin 4 të nenit 14 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar dhe ti zëvendësojë këta paragrafë me dispozitat e paraqitura në shtojcën e kësaj resolute.

9. *Vendos* që të mbetet i angazhuar me këtë çështje.

Shtojcë

Neni 14

Zyrtarët dhe anëtarët e Dhomave

3. Pas konsultimeve me gjykatësit e përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar, Kryetari cakton në Dhomën e Apelit katër gjykatës të përhershëm të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 13 *bis* të Statutit dhe nëntë syresh në Dhomat Gjyqësore. Pavarësisht dispozitave të nenit 12, paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 12, Kryetari mund të caktojë në Dhomën e Apelit deri në katër gjykatës të përhershëm shtetë të cilët janë në Dhomat Gjyqësore për përfundimin e të tëra çështjeve ku është caktuar secili prej këtyre gjykatësve. Koha e shërbimit të çdo gjykatësi të ricaktuar në Dhomën e Apelit është e njëjtë me kohën e shërbimit të gjykatësve që shërbejnë në Dhomën e Apelit.

4. Dy gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me Nenin 12 *bis* të Statutit të atij Tribunali caktohen nga Kryetari i atij Tribunali, në konsultim me Kryetarin e Tribunalit Ndërkombëtar, që të jenë anëtarë të Dhomës së Apelit dhe gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar. Pavarësisht dispozitave të nenit 12, paragrafëve 1 dhe 3 të nenit 12, Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën mund të caktojë në Dhomën e Apelit deri në katër gjykatës të përhershëm të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën për përfundimin e të tëra çështjeve ku është caktuar secili prej këtyre gjykatësve. Koha e shërbimit të çdo gjykatësi të ricaktuar në Dhomën e Apelit është e njëjtë me kohën e shërbimit të gjykatësve që shërbejnë në Dhomën e Apelit.

REZOLUTAT QË KANË LIDHJE

Rezoluta që nuk përmbajnë ndryshime të Statutit, por që kanë lidhje me TPNJ-në.

REZOLUTA 1503 (2003).....	62
Shtojca I.....	64
REZOLUTA 1504 (2003).....	66
REZOLUTA 1534 (2004).....	68
REZOLUTA 1581 (2005).....	70
REZOLUTA 1613 (2005).....	72
REZOLUTA 1629 (2005).....	75
REZOLUTA 1668 (2006).....	77
REZOLUTA 1775 (2007).....	79
REZOLUTA 1786 (2007).....	81
REZOLUTA 1800 (2008).....	83

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1503 (2003)
28 gusht 2003

REZOLUTA 1503 (2003)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4817
më 28 gusht 2003**

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 955 (1994) të 8 nëntorit 1994, 978 (1995) të 27 shkurtit 1995, 1165 (1998) të 30 prillit 1998, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002, 1431 (2002) të 14 gushtit 2002, dhe 1481 (2003) të 19 majit 2003,

Duke marrë shënim letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 28 korrik 2003 (S/2003/766),

Duke shprehur vlerësim për punën e rëndësishme të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për -ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) në kontributin për paqen dhe sigurinë e qëndrueshme në ish-Jugosllavi dhe Ruanda dhe përparimin e bërë që prej themelimit të tyre,

Duke theksuat se parakusht thelbësor për plotësimin e objektivave të Strategjive Përmbyllëse të TPNJ-së dhe TPNR-së është bashkëpunimi i plotë i të gjithë shteteve, veçanërisht në lidhje me arrestimin e të tërë personave ende në arrati, të akuzuar prej TPNJ-së dhe TPNR-së,

Duke përshëndetur masat e marra nga shtetet në Ballkan dhe në rajonin e Liqeneve Të Mëdhenj në Afrikë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe arrestimin e personave në arrati të akuzuar prej TPNJ-së dhe TPNR-së, por duke theksuar me shqetësim se disa shtete ende nuk ofrojnë bashkëpunim të plotë,

Duke nxitur shtetet anëtare për marrjen e masave kundër individëve dhe grupeve ose organizatave që ndihmojnë të akuzuarit në arrati në vazhden e ikjes prej drejtësisë, ndër të cilat masa për kufizimin e udhëtimeve dhe bllokimin e mjeteve financiare të këtyre individëve, grupeve ose organizatave,

Duke kujtuar dhe riafirmuar në mënyrën më të vendosur deklaratën e 23 korrikut 2002 dhënë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit (S/PRST/2002/21) ku mbështetej strategjia e TPNJ-së për përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, të gjitha proceset gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008 dhe krejt punën e tij në vitin 2010 (Strategjia përmbyllëse e TPNJ-së) (S/2002/678), nëpërmjet përqëndrimit në ndjekjen penale dhe gjykimin e udhëheqësve më të lartë të dyshuar si përgjegjës për krimet brenda juridiksionit të TPNJ-së dhe transferimin e çështjeve në lidhje me individë që nuk kanë këtë nivel përgjegjësie në juridiksionet shtetërore përkatëse si i përshtatshëm si dhe fuqizimin e kapaciteteve të këtyre juridiksioneve,

Duke nxitur TPNR-në për formalizimin e një strategjie të hollësishme të bazuar në Strategjinë Përmbyllëse të TPNJ-së për transferimin e çështjeve të personave të nivelit të mesëm dhe të ulët juridiksioneve kompetente shtetërore në rast se është e përshtatshme, duke përfshirë edhe Ruandën, për t'i mundësuar TPNR-së plotësimin e objektivave të veta me përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, të tëra proceseve gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008, dhe krejt punën e vetë në 2010 (Strategjia Përmbyllëse e TPNR-së),

Duke theksuar se Strategjitë Përmbyllëse të lartpërmendura nuk ndryshojnë në asnjë mënyrë detyrimin e Ruandës dhe vendeve të ish-Jugosllavisë për hetimin e të akuzuarve çështjet e të cilëve nuk do të gjykohen prej

TPNR-së ose TPNJ-së dhe të marrin masa të përshtatshme lidhur me aktakuzat dhe ndjekjen penale, duke mbajtur njëkohësisht parasysh përparësinë e TPNJ-së dhe TPNR-së ndaj gjykatave shtetërore,

Duke theksuar se fuqizimi i sistemeve shtetërore gjyqësore është i një rëndësie kyçe për shtetin ligjor në tërësi dhe për zbatimin e Strategjive Përmbyllëse të TPNJ-së dhe TPNR-së në veçanti,

Duke theksuar se parakusht thelbësor për plotësimin e objektivave të Strategjisë Përmbyllëse të TPNJ-së është krijimi dhe vënia sa më shpejt në funksionim e një seksioni të veçantë nën autoritetin e Përfaqësuesit të Lartë, brenda Gjykatës Shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës (“Dhoma për Krimet e Luftës”) dhe transferimi i mëvonshëm prej TPNJ-së i çështjeve të të akuzuarve të nivelit të mesëm dhe të ulët, kësaj Dhome,

I bindur se TPNJja dhe TPNR-ja mund të përmbushin përgjegjësitë e tyre përkatëse në mënyrë eficiente dhe të shpejtë nëqoftëse se çdo Tribunal ka Prokurorin e vet,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. *I bën thirrje* bashkësisë ndërkombëtare të ndihmojë juridiksionet shtetërore në kuadër të strategjisë përmbyllëse në përmirësimin e kapacitetit të tyre për procedimin e çështjeve të transferuara nga TPNJ-ja dhe TPNR-ja dhe inkurajon Kryetarët, Prokurorët dhe Sekretarët e TPPNJ-së dhe TPNR-së të zhvillojnë dhe përmirësojnë programet e tyre të komunikimit dhe vetëdijësimin;

2. *U bën thirrje* të gjitha shteteve, veçanërisht Serbisë dhe Malit të Zi, Kroacisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Republikës Serbe brenda Bosnjës dhe Hercegovinës që të shtojnë bashkëpunimin me TPNJ-në dhe t’i ofrojnë tërësisht ndihmën e nevojshme, veçanërisht në transferimin e Radovan Karagjiqit dhe Ratko Mlladiqit si dhe të Ante Gotovinës dhe të gjithë të akuzuarve të tjerë në TPNJ-në dhe u bën thirrje këtyre individëve dhe gjithë të akuzuarve të tjerë në arrati që t’i dorëzohen TPNJ-së;

3. *U bën thirrje* të tëra shteteve, veçanërisht Ruandës, Kenias, Republikës Demokratike të Kongos dhe Republikës së Kongos që të shtojnë bashkëpunimin me TPNR-në dhe t’i ofrojnë tërësisht ndihmën e nevojshme, duke përfshirë edhe hetimet e Ushtrisë Patriotike të Ruandës dhe përpjekjet për sjelljen e Felicien Kabugës dhe të akuzuarve të tjerë në TPNR dhe u bën thirrje këtij individit dhe të gjithë të akuzuarve në arrati prej TPNR-së, që t’i dorëzohen TPNR-së;

4. *U bën thirrje* të tëra shteteve që të bashkëpunojnë me Organizatën Ndërkombëtare të Policisë për Krimet (ICPO-Interpol) në arrestimin dhe transferimin e të akuzuarve prej TPNJ-së dhe TPNR-së;

5. *U bën thirrje* të gjithë donatorëve që të mbështesin punën e Përfaqësuesit të Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë në krijimin e një dhome të veçantë brenda Gjykatës Shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës për gjykimin e akuzave për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare;

6. *Kërkon* që Kryetarët dhe Prokurorët e TPNJ-së dhe TPNR-së në raportet e tyre vjetore, të shpjegojnë planet e tyre për zbatimin e Strategjive Përmbyllëse të TPNJ-së dhe TPNR-së;

7. *U bën thirrje* TPNJ-së dhe TPNR-së të marrin të tëra masat e mundshme për përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, të përfundojnë proceset gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008, dhe të përfundojnë kreu punën në 2010 (Strategjitë Përmbyllëse);

8. *Vendos* të ndryshojë Nenin 15 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën dhe ta zëvendësojë këtë Nen me dispozitën e paraqitur në Shtojcën I të kësaj rezolute, dhe i kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të paraqesë një kandidaturë për Prokuror të TPNR-së;

9. *Përshëndet* synimin e shprehur prej Sekretarit të Përgjithshëm në letrën e tij të datës 28 korrik 2003, për t’i paraqitur Këshillit të Sigurimit emrin e Znj. Carla Del Ponte si kandidate për Prokuror të TPNJ-së;

10. *Vendos* të mbetet aktivisht i angazhuar me çështjen.

Shtojca I

Neni 15 Prokurori

1. *Prokurori* është përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen penale të individëve përgjegjës për shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare në territorin e Ruandës dhe të shtetasve të Ruandës përgjegjës për kryerjen e këtyre shkeljeve të kryera në territorin e shteteve fqinje për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 1994.

2. *Prokurori* vepron në mënyrë të pavarur si organ i veçantë i Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën. Ai/ajo nuk kërkon dhe nuk merr udhëzime prej asnjë qeverie ose burimi tjetër.

3. *Zyra* e Prokurorit përbëhet nga prokurori dhe, sipas nevojës, nga personel tjetër i kualifikuar.

4. *Prokurori* emërohet nga Këshilli i Sigurimit pas propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm. Ai ose ajo duhet të jetë me karakter të lartë moral dhe të ketë nivelin më të lartë të aftësisë dhe të përvojës në kryerjen e hetimeve dhe procedimin e çështjeve penale. Prokurori shërben për një mandat katërvjeçar dhe ka të drejtë të riemërohet. Kushtet e shërbimit të Prokurorit janë si ato të një Nënsekretari të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

5. *Personeli* i Zyrës së Prokurorit emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm me rekomandim të Prokurorit.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1504 (2003)
4 shtator 2003

REZOLUTA 1504 (2003)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4819
më 4 shtator 2003**

Këshilli i Sigurimit,

Duke kujtuar rezolutën e vetë 1503 (1993) të 28 gushtit 2003,

Duke theksuar se me atë rezolutë Këshilli krijoi funksionin e ri të Prokurorit të Tribunalit Ndërkombëtar për Ruandën,

Duke theksuar se në rezolutën e tij 1503 (2003) Këshilli përshëndeti synimin e Sekretarit të Përgjithshëm për t'i paraqitur Këshillit emrin e Znj. Carla Del Pontes si kandidate për Prokurorë të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,

Duke marrë parasysh Nenin 16(4) të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,

Duke marrë parasysh propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të kandidaturës së Znj. Carla Del Ponte si Prokurore e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,

Emëron Znj. Carla Del Ponte si Prokurore e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, për një mandate katërvjeçar që fillon prej 15 shtatorit 2003.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1534 (2004)
26 mars 2004

REZOLUTA 1534 (2004)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 4935
më 26 mars 2004**

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 955 (1994) të 8 nëntorit 1994, 978 (1995) të 27 shkurtit 1995, 1165 (1998) të 30 prillit 1998, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002, 1431 (2002) të 14 gushtit 2002, dhe 1481 (2003) të 19 majit 2003,

Duke kujtuar dhe riafirmuar në mënyrën më të vendosur deklaratën e 23 korrikut 2002 dhënë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit (S/PRST/2002/21) që mbështet strategjinë përmbyllëse të TPNJ-së dhe rezolutën e vetë 1503 (2003) të 28 gushtit 2003,

Duke kujtuar se rezoluta 1503 (2003) u bënte thirrje Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) dhe Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (TPNR) për marrjen e të tëra masave të mundshme për përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, të të gjitha proceseve gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008 dhe krejt punën në vitin 2010 (Strategjitë Përmbyllëse) dhe kërkoi që Kryetarët dhe Prokurorët e TPNJ-së dhe TPNR-së në raportet e tyre vjetore për Këshillin, të shpjegojnë planet e tyre për zbatimin e Strategjive të tyre Përmbyllëse;

Duke përshëndetur shpjegimet e bëra nga Kryetarët dhe Prokurorët e TPNJ-së dhe TPNR-së në Këshillin e Sigurimit më 9 tetor 2003,

Duke shprehur vlerësim për punën e rëndësishme të dy Tribunalëve në kontributin për paqen dhe sigurinë e qëndrueshme dhe pajtimin kombëtar dhe për përparimin e bërë që prej krijimit të tyre, duke vlerësuar përpjekjet e tyre të deritanishme për jetësimin e Strategjive Përmbyllëse dhe duke u bërë thirrje për mundësimin e përdorimit efektiv dhe eficient të buxheteve të tyre me përgjegjësi;

Duke ritheksuar mbështetjen për përpjekjet e vazhdueshme të Prokurorëve të TPNJ-së dhe TPNR-së për sjelljen në TPNJ dhe TPNR të të akuzuarve në arrati;

Duke shprehur shqetësim për problemet e theksuara në shpjegimet në Këshillin e Sigurimit më 9 tetor 2003, në sigurimin e bashkëpunimit rajonal të mjaftueshëm,

Duke shprehur gjithashtu shqetësim për paralajmërimet në shpjegimet e bëra më 9 tetor 2003 se zbatimi i Strategjive Përmbyllëse përcaktuar në rezolutën 1503 (2003) mund të mos jetë i mundshëm,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. *Riafirmon* domosdoshmërinë e gjykimit të personave të akuzuar nga TPNJ-ja dhe u bën thirrje sërish të gjithë shteteve, veçanërisht Serbisë dhe Malit të Zi dhe Bosnjës dhe Hercegovinës si dhe Republikës Serbe brenda Bosnjës dhe Hercegovinës që të shtojnë bashkëpunimin me TPNJ-në dhe t'i ofrojnë tërësisht ndihmën e

nevojshme, veçanërisht në transferimin e Radovan Karagjiqit dhe Ratko Mlladiqit si dhe të Ante Gotovinës dhe gjithë të akuzuarve të tjerë në TPNJ- dhe u bën thirrje të gjithë të akuzuarve në arrati që t'i dorëzohen TPNJ-së;

2. *Riafirmon* domosdoshmërinë e gjykimit të personave të akuzuar nga TPNR-ja dhe u bën thirrje sërish të gjithë shteteve veçanërisht Ruandës, Kenias, Republikës Demokratike të Kongos dhe Republikës së Kongos që të shtojnë bashkëpunimin me TPNR-në dhe t'i ofrojnë tërësisht ndihmën e nevojshme, duke përfshirë edhe hetimet e Ushtrisë Patriotike të Ruandës dhe përpjekjet për sjelljen e Felicien Kabugës dhe të gjithë të akuzuarve të tjerë në TPNR dhe u bën thirrje të gjithë të akuzuarve në arrati prej TPNR-së, që t'i dorëzohen TPNR-së;

3. *Thekson* rëndësinë e zbatimit të plotë të Strategjive Përmbyllëse siç përcaktohet në paragrafin 7 të rezolutës 1503 (2003) që u bën thirrje TPNJ-së dhe TPNR-së të marrin të tëra masat e mundshme për përfundimin e hetimeve brenda fundit të vitit 2004, të përfundojnë proceset gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008, dhe të përfundojnë krejt punën në 2010 dhe nxit secilin prej Tribunalëve që të planifikojnë dhe veprojnë në përputhje me sa më sipër;

4. *U bën thirrje* Prokurorëve të TPNJ-së dhe TPNR-së që të shqyrtojnë ngarkesën e çështjeve përkatësisht të TPNJ-së dhe TPNR-së veçanërisht me synim që të përcaktojnë cilat çështje duhen proceduar dhe cilat çështje duhen transferuar në sistemet gjyqësore shtetërore kompetente si dhe për masat që do të duhet të merren për plotësimin e Strategjive Përmbyllëse të përmendura në rezolutën 1503 (2003) dhe i nxit që ta përfundojnë këtë shqyrtim sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në vlerësimet që do t'i japin Këshillit bazuar në paragrafin 6 të kësaj rezolute të përfshijnë edhe një raport për përparimin;

5. *I bën thirrje* çdo Tribunali gjatë shqyrtimit dhe konfirmimit të aktakuzave të reja që të garantojnë se këto aktakuza kanë lidhje me udhëheqësit më të lartë të dyshuar për përgjegjësinë kryesore për krimet brenda juridiksionit të Tribunalit përkatës siç është përcaktuar në rezolutën 1503 (2003);

6. *Kërkon* që brenda 31 majit 2004 dhe më pas çdo gjashtë muaj, secili Tribunal t'i paraqesë Këshillit vlerësime të hollësishme në lidhje me përparimin e bërë për zbatimin e Strategjisë Përmbyllëse të Tribunalit dhe çfarë masash mbeten për t'u marrë ndër të cilat transferimi i çështjeve të të akuzuarve të nivelit të mesëm dhe të ulët në sistemet gjyqësore shtetërore kompetente; dhe shpreh synimin e Këshillit për takimin me Kryetarin dhe Prokurorin e çdo Tribunali për të diskutuar këto vlerësime;

7. *Deklaron* vendosmërinë e Këshillit për shqyrtimin e rrethanave dhe bazuar në vlerësimet e marra në bazë të paragrafit të mëparshëm të mundësojë plotësimin e afateve kohore të përcaktuara në Strategjitë Përmbyllëse dhe të mbështetura prej rezolutës 1503 (2003);

8. *Shpreh vlerësim* për të tërë shtetet që kanë përfunduar marrëveshje për zbatimin e dënimeve të personave të shpallur fajtorë prej TPNJ-së ose TPNR-së ose përndryshe kanë pranuar personat e fajësuar që të kryejnë dënimin në territoret e tyre përkatëse; inkurajon shtete të tjerë që kanë mundësi që të veprojnë në mënyrë të ngjashme; dhe fton TPNJ-në dhe TPNR-në që të shtojnë përpjekjet për arritjen e marrëveshjeve për zbatimin e dënimeve ose të sigurojnë bashkëpunimin e shteteve në lidhje me këtë;

9. *Kujton* se fuqizimi i sistemeve gjyqësore shtetërore është i një rëndësie kyçe për shtetin ligjor në përgjithësi dhe për zbatimin e Strategjive Përmbyllëse të TPNJ-së dhe TPNR-së në veçanti;

10. *Përsëendet* në veçanti përpjekjet e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë, të TPNJ-së dhe donatorëve për krijimin e një dhome për krime të luftës në Sarajevë; inkurajon të tëra palët që të vazhdojnë përpjekjet për krijimin e shpejtë të kësaj dhome; dhe inkurajon donatorët që të ofrojnë mbështetje të mjaftueshme financiare për garantimin e suksesit të procedimeve penale brenda shteteve, në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në rajon;

11. *Vendos* të mbetet aktivisht i angazhuar me çështjen.

KOMBET
E BASHKUARA

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1581 (2005)
18 janar 2005

REZOLUTA 1581 (2005)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5112
më 18 janar 2005**

Këshilli i Sigurimit,

Duke marrë shënim letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të datës 6 janar 2005 (S/2005/9),

Duke kujtuar rezolutat e veta 1503 (2003) të 28 gushtit 2003 dhe 1534 (2004) e 26 marsit 2004.

Duke mbajtur parasysh deklaratën e bërë në Këshillin e Sigurimit gjatë mbledhjes 5086 më 23 nëntor 2004 prej Kryetarit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) ku ai shprehu angazhimin e Tribunalit Ndërkombëtar ndaj Strategjisë Përmbyllëse,

Duke shprehur shpresën se zgjatja e mandatit të gjykatësve *ad litem* do të shtojë efektivitetin e proceseve gjyqësore dhe do të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë Përmbyllëse.

1. Në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm vendos që:

- (a) Gjykatësi Rasoazanany dhe gjykatësi Swart, menjëherë pasi të zëvendësohen si gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar, të përfundojnë çështjen *Haxhihasanoviq*, të cilën e filluan para përfundimit të mandatit të tyre
- (b) Gjykatësi Brydensholt dhe gjykatësi Eser, menjëherë pasi të zëvendësohen si gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar, të përfundojnë çështjen *Oriq*, të cilën e filluan para përfundimit të mandatit të tyre
- (c) Gjykatësi Thelin dhe gjykatësja Van den Wyngaert, menjëherë pasi të zëvendësohen si gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar, të përfundojnë çështjen *Limaj*, të cilën e filluan para përfundimit të mandatit të tyre;
- (d) Gjykatësi Canivell, menjëherë pasi të zëvendësohet si gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar, të përfundojë çështjen *Krajishnik*, të cilën e filloi para përfundimit të mandatit të tij;
- (e) Gjykatësi Szénási, nëqoftëse emërohet në Tribunalin Ndërkombëtar për gjykimin e çështjes *Haliloviq*, dhe menjëherë pasi të zëvendësohet si gjykatës *ad litem* i Tribunalit Ndërkombëtar, të përfundojë këtë çështje të cilën do ta kishte filluar para përfundimit të mandantit të tij;
- (f) Gjykatësi Hanoteau, nëqoftëse emërohet në Tribunalin Ndërkombëtar për gjykimin e çështjes *Krajishnik*, dhe menjëherë pasi të zëvendësohet si gjykatës *ad litem* i Tribunalit Ndërkombëtar, të përfundojë këtë çështje të cilën do ta kishte filluar para përfundimit të mandantit të tij;

2. *Duke marrë shënim* në lidhje me këtë synimin e Tribunalit Ndërkombëtar për përfundimin e çështjes *Haxhihasanoviq* para fundit të shtatorit 2005, çështjes *Haliloviq* para fundit të tetorit 2005, çështjeve *Oriq* dhe *Limaj* para fundit të nëntorit 2005 dhe çështjes *Krajishnik* para fundit të prillit 2006.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1613 (2005)
26 korrik 2005

REZOLUTA 1613 (2005)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5236
më 26 korrik 2005**

Këshilli i Sigurimit,

Duke riafirmuar rezolutat e veta 827 (1993) të 25 majit 1993, 1166 (1998) të 13 majit 1998, 1329 (2000) të 30 nëntorit 2000, 1411 (2002) të 17 majit 2002, 1431 (2002) të 14 gushtit 2002, 1481 (2003) të 19 majit 2003, 1503 (2003) të 28 gushtit 2003, 1534 (2004) të 26 marsit 2004 dhe 1597 (2005) të 20 prillit 2005,

Pasi ka shqyrtuar kandidatët e propozuar si gjykatës *ad litem* të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë marrë prej Sekretarit të Përgjithshëm,

I përcjell Asamblesë së Përgjithshme kandidatët e propozuar të mëposhtëm në përputhje me Nenin 13 *ter* (1) (d) të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar:

Z. Tanvir Bashir Ansari (Pakistan)
Z. Melville Baird (Trinidad dhe Tobago)
Z. Frans Bauduin (Holandë)
Z. Giancarlo Roberto Belleli (Itali)
Z. Ishaq Usman Bello (Nigeri)
Z. Ali Nawaz Chowhan (Pakistan)
Z. Pedro David (Argjentinë)
Z. Ahmad Farawati (Republika Arabe Siriane)
Znj. Elizabeth Gwaunza (Zimbabve)
Z. Burton Hall (Bahama)
Z. Frederik Harhoff (Danimarkë)
Z. Frank Höpfel (Austri)
Znj. Tsvetana Kamenova (Bullgari)
Z. Muhammad Muzammal Khan (Pakistan)
Z. Uldis Kinis (Letoni)
Z. Raimo Lahti (Finlandë)
Znj. Flavia Lattanzi (Itali)
Z. Antoine Mindua (Republika Demokratike e Kongos)
Z. Jawdat Naboty (Republika Arabe Siriane)
Znj. Janet Nosworthy (Xhamaika)
Znj. Chioma Egongdu Nwosu-Iheme (Nigeri)
Znj. Prisca Matimba Nyambe (Zambia)
Znj. Michèle Picard (Francë)
Z. Brynmor Pollard (Guaiana)
Z. Árpád Prandler (Hungari)
Znj. Kimberly Prost (Kanada)
Z. Sheikh Abdul Rashid (Pakistan)
Znj. Vonimbolana Rasoazanany (Madagaskar)
Z. Ole Bjørn Støle (Norvegji)

Z. Krister Thelin (Suedi)
Z. Klaus Tolksdorf (Gjermani)
Z. Stefan Trechsel (Zvicër)
Z. Abubakar Bashir Wali (Nigeri)
Z. Tan Sri Dato Lamin Haji Mohd Yunus (Malajzi)

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1629 (2005)
30 shtator 2005

REZOLUTA 1629 (2005)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5273
më 30 shtator 2005**

Këshilli i Sigurimit,

Duke marrë shënim letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit, të datës 14 shtator 2005 (S/2005/593),

*Vendos që pavarësisht Nenit 12 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe pavarësisht faktit se detyra e gjykatës Christine Van den Wyngaert si gjykatëse e përhershme e Tribunalit në përputhje me Nenin 13 të Statutit të Tribunalit do të fillojë më 17 nëntor 2005, ajo të caktohet si gjykatëse e përhershme në çështjen *Mërksiq dhe të tjerët* e cila do të fillojë më 3 tetor 2005.*

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



KËSHILLI I SIGURIMIT

Shpërndarje
E PËRGJITHSHME

S/RES/1668 (2006)
10 prill 2006

REZOLUTA 1668 (2006)

**Miratuar prej Këshillit të Sigurimit në mbledhjen e tij 5407
më 10 prill 2006**

Këshilli i Sigurimit,

Duke kujtuar rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1581 (2005) të 18 janarit 2005,

Duke marrë shënim letrën e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit, të datës 27 mars 2006,

Në përgjigje të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm vendos të konfirmojë se Gjykatësi Joaquin Canivell mund të vazhdojë të marrë pjesën në çështjen Krajishnik përtej prillit 2006 dhe të qëndrojë deri në fund të çështjes, pavarësisht faktit se periudha e gjithsejtë e shërbimit të tij në Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë deri në atë kohë do të ketë arritur dhe kaluar afatin e tre vjetëve,

Vendos të mbetet i angazhuar me çështjen.

**KOMBET
E BASHKUARA**



Këshilli i Sigurimit

Shpërn.
E PËRGJITHME

S/RES/1775 (2007)
14 shtator 2007

REZOLUTA 1775 (2007)

**Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij 5742,
më 14 shtator 2007**

Këshilli i Sigurimit,

Duke kujtuar rezolutën e tij 1504 (2003) të 4 shtatorit 2003,

Duke marrë parasysh Nenin 16 (4) të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë,

I vetëdijshëm se mandati i Znj. Carla Del Ponte si Prokurore e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë mbaron më 14 shtator 2007,

Duke theksuar nevojën për të siguruar një periudhë kalimtare pa probleme midis largimit të Znj. Carla Del Ponte dhe marrjes së detyrës nga pasardhësi i saj,

Duke marrë parasysh kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm për zgjatjen e mandatit të Znj. Del Ponte nga 15 shtator 2007 deri më 31 dhjetor 2007 (S2007538),

Duke konstatuar synimin e Sekretarit të Përgjithshëm për paraqitjen e emrit të kandidatit të propozuar prej tij për postin e Prokurorit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë,

Vendos që, pavarësisht nga dispozitat e nenit 16 (4) të Statutit, të zgjasë përfundimisht mandatin e Znj. Carla Del Ponte si Prokurore e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë nga 15 shtator 2007 deri më 31 dhjetor 2007.

**KOMBET
E BASHKUARA**

S



Këshilli i Sigurimit

Shpërnd.
E PËRGJITHSHME

S/RES/1786 (2007)
28 nëntor 2007

REZOLUTA 1786 (2007)

**Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij 5785,
më 28 nëntor 2007**

Këshilli i Sigurimit,

Duke kujtuar rezolutën e tij 1775 (2007) të 14 shtatorit 2007,

Duke marrë parasysh Nenin 16 (4) të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë,

Duke marrë parasysh caktimin nga Sekretari i Përgjithshëm të kandidaturës së Z. Serge Brammertz për postin e Prokurorit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (S/2007/678),

Duke kujtuar se rezoluta 1503 (2003) e 28 gushtit 2003 i bënte thirrje Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë të merrte të tëra masat e mundshme për përfundimin e proceseve gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008, dhe për përfundimin e krejt punës në 2010. (Strategjia Përmblyëse e TPNJ-së),

Duke kujtuar gjithashtu rezolutën e tij 1534 (2004) të 26 marsit 2004 e cila thekson rëndësinë e zbatimit të plotë të strategjisë së përmblyës së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe nxit Tribunalin që të marrë masat përkatëse planifikuese dhe zbatuese,

Vendos të emërojë Z. Serge Brammertz si Prokuror të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë duke filluar nga 1 janari 2008 për një mandat katërvjeçar, i cili mund të ndërpritet edhe më shpejt nga Këshilli i Sigurimit në rast se Tribunali përfundon punën e tij.

**KOMBET E
BASHKUARA**

S



Këshilli i Sigurimit

Shpërn.
E PËRGJITHSHME

S/RES/1800 (2008)
20 shkurt 2008

REZOLUTA 1800 (2008)

**Miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e tij 5841,
më 20 shkurt 2008**

Këshilli i Sigurimit,

Duke kujtuar rezolutat e tij 1581 (2005) të 18 janarit 2005, 1597 (2005) të 20 prillit 2005, 1613 (2005) të 26 korrikut 2005, 1629 (2005) të 30 shtatorit 2005, 1660 (2006) të 28 shkurtit 2006 dhe 1668 (2006) të 10 prillit 2006,

Duke marrë shënim letrat e Sekretarit të Përgjithshëm për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit, të datave 31 dhjetor 2007, 22 janar 2008 dhe 8 shkurt 2008,

Pasi ka shqyrtuar propozimin e bërë nga Kryetari i Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (Tribunali Ndërkombëtar), sipas të cilit Sekretari i Përgjithshëm duhet të autorizohet, bazuar në burimet ekzistuese, të emërojë gjykatës shtesë *ad litem* me kërkesë të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar, pavarësisht faktit se, herë pas here, numri i tyre do të jetë më i lartë se maksimumi 12 i përcaktuar në nenin 12 (1) të Statutit, duke arritur në shifrën 16 në një moment të caktuar, dhe duke rënë përsëri në kufirin 12 brenda datës 31 dhjetor 2008, në mënyrë që Tribunali Ndërkombëtar të mund të kryejë procese gjyqësore shtesë kur janë të disponueshëm një apo më shumë nga gjykatësit e përhershëm,

Duke kujtuar se rezoluta 1503 (2003) e 28 gushtit 2003 i bënte thirrje Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë të merrte të tëra masat e mundshme për përfundimin e proceseve gjyqësore të shkallës së parë brenda fundit të vitit 2008, dhe për përfundimin e krejt punës në 2010. (Strategjia Përmblyëse e Tribunalit Ndërkombëtar) dhe se rezoluta 1534 (2004) e 26 marsit 2004 theksonte rëndësinë e zbatimit të plotë të strategjisë përmblyëse së Tribunalit Ndërkombëtar,

I bindur për dobinë e këshillës se Sekretari i Përgjithshëm duhet të lejohet të emërojë Gjykatës shtesë *ad litem* mbi numrin 12 të Gjykatësve *ad litem* të autorizuar nga Statuti, si një masë e përkohshme për t'i mundësuar Tribunalit Ndërkombëtar të kryerjë procese gjyqësore shtesë sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim arritjen e objektivave të strategjisë përmblyëse,

Duke vepruar në bazë të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

1. *Rrjedhimisht vendos*, që Sekretari i Përgjithshëm të mund të emërojë gjykatës shtesë *ad litem* me kërkesë të Kryetarit të Tribunalit Ndërkombëtar pavarësisht faktit se, herë pas here, numri i tyre do të jetë më i lartë se maksimumi 12 i përcaktuar në nenin 12 (1) të Statutit, duke arritur në shifrën 16 në një moment të caktuar, dhe duke rënë përsëri në kufirin 12 brenda datës 31 dhjetor 2008

2. *Vendos* të mbetet i angazhuar me këtë çështje.